



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 16/2019 regjistër (JR)
Datë 01.04.2019

Nr. 10 i vendimit
Datë 01.07.2020

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga:

Luan Daci	Kryesues
Albana Shtylla	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 01.07.2020, ditën e mërkurë, në orën 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Branko Hrvatin, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Arben Zefi, gjyqtar, me detyrë kryetar, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Arben Zefi, në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka mbajtur detyrën e gjyqtarit dhe

kryetarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Arben Zefi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe c) Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “KLD”), sipas të cilave ka rezultuar:

1.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

1.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i rishikuar në vijimësi, ku ka konstatuar *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës si gjyqtar të subjektit të rivlerësimit.*

1.3 KLD-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar tri dokumente ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

- 2.** Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar vetëm në dy kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë dhe kontrolli i figurës, duke marrë vendimin nr. 97, datë 10.01.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

- 3.** Komisioni, me vendimin nr. 97, datë 10.01.2019, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, me detyrë gjyqtar dhe kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pikat 3 e 5 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit, si më poshtë.

3.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

- *Për pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 132,8 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Shkodër:*

- *ka bërë deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, për shkak se nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit;*

- *ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë dhe të dytë për blerjen e apartamentit, në shumën 463272 lekë për vitin 2004 dhe në shumën 1129645 lekë për vitin 2005.*

- *Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 56,1 m², ndodhur në Shkodër:*
 - ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi duke mos deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit të ardhurat në shumën 1.900.000 lekë, të përfituara nga shitja e këtij apartamenti.
 - nuk shpjegoi bindshëm mënyrën e përdorimit të shumës prej 1.900.000 lekësh. Ai nuk paraqiti dokumentacion ligjor justifikues që të provonte deklaratimet e tij;
 - nuk provoi me dokumentacion provues se atij i takonte të përfitonte shumën prej 800.000 lekësh nga Enti Kombëtar i Banesave në përputhje me legjislacionin në fuqi të kohës.
- *Për pasurinë automjet tip “BMW”, blerë në vitin 2007, me targë {***}:*
 - ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, në lidhje me pronësinë dhe vitin e blerjes së automjetit;
 - ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e automjetit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.
- *Për pasuritë automjet tip “Mercedes Benz” dhe automjet tip “Volkswagen Passat”, në huapërdorje nga z. A. H.:*
 - ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz”;
 - ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk ka deklaruar shitjen/shkëmbimin e automjetit tip “Mercedes Benz” me automjetin tip “Volkswagen Passat”;
 - shkëmbimi i automjeteve i kryer nga subjekti i rivlerësimit përbën një veprim financiar të pajustificuar dhe të pambështetur në parimet e ekonomisë së tregut (parimi i fitimit), përderisa shitësi shet me një çmim më të ulët mallin e sapoblerë.
- *Në lidhje me likuiditetet:*
 - ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar dhënien e shumës 50.000 euro shoqërisë “{***}” ShPK, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit;
 - ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për dhënien e shumës prej 50.000 eurosh, shoqërisë “{***}” ShPK;
 - ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, shumën 300.000 lekë, në formën e depozitës pranë Tirana Bank;
 - ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin pasi nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, gjendjen në llogarinë në lekë pranë Tirana Bank;
 - ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit në lidhje me përdorimin e të ardhurave të tij;
 - ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për të mbuluar shpenzimet e kryera në {***} nga ana e personit të tretë (vëllai i tij), për vitet 2006, 2007 dhe 2009;
 - ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk ka deklaruar marrjen e shumës 100.000 USD nga z. R. D., në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si dhe ka dhënë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me këtë shumë.
- *Në lidhje me pasuritë e padeklaruara:*
 - ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit marrëveshjen që ka pasur me shoqërinë “{***}” ShPK, për përfitimin e pasurive të paluajtshme;
 - ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi ka dhënë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me marrëdhënien që ka me shoqërinë “{***}” ShPK;
 - gjendet në situatën e konfliktit të interesit, pasi ka shqyrtuar një padi të shoqërisë “{***}” ShPK, duke qenë ende në marrëdhënie interesi me të;
 - ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit pjesën takuese të bashkëshortes së tij në një godinë 3-katëshe ndodhur në Velipojë;

- ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk provoi se kishte tagrat e përfaqësimit për të shitur automjetin tip “BMW”, me targë {***};
- ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit automjetin me targë {***}.

3.2 Për kontrollin e figurës:

Përfundimet e nxjerra nga raporti i DSIK-së dhe shqyrtimi i tij në tërësi, janë të pamjaftueshme për t’u konsideruar si shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, por ato merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

4. Komisioni, pas shqyrtimit përfundimtar të çështjes, ka arritur në përfundimin se *subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes rezulton se ai ka cenuar besimin e publikut.*

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit, më datë 10.03.2019, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit, ankim i cili është pranuar nga Komisioni, me vendimin nr. 97/1, datë 21.03.2019.
6. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrën e gjyqtarit dhe kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, bazuar në shkaqet si më poshtë.

A. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

6.1 Subjekti i rivlerësimit, në asnjë rast, nuk është përpjekur të fshehë apo të deklarojë në mënyrë të pasaktë pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 132,8 m² në Shkodër. Burimi i blerjes së kësaj pasurie është i ligjshëm, pasi përbëhet nga të ardhurat nga pagat, tërheqjet e kursimeve nga depozitat bankare, si dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 56,1 m² në Shkodër, të cilat padrejtësisht nuk janë konsideruar nga Komisioni.

6.2 Apartamenti i banimit me sipërfaqe 56,1 m², në Shkodër, është përfituar nga subjekti i rivlerësimit në përputhje me legjislacionin e kohës që rregullonte të drejtën e përfitimit të banesave për familjet e pastreha, nëpërmjet lidhjes së një kontrate me Entin Kombëtar të Banesave. Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk provoi me dokumentacion provues se i takonte të përfitonte strehim nga Enti Kombëtar i Banesave, duke bërë një arsyetim jashtë objektit ligjor të punës së tij, duke vlerësuar punën dhe veprimtarinë e institucionit dhe jo atë të subjektit të rivlerësimit.

6.3 Konkluzioni i Komisionit për automjetin tip “BMW”, blerë në vitin 2007, nuk është i drejtë, pasi gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të plota në lidhje me këtë mjet dhe ka argumentuar qartë pozicionin e tij. Pasaktësia në deklarin ka ardhur si pasojë e prezumimit të bërë prej tij, se mosdeklarin i burimit të të ardhurave nënkupton se ato burojnë nga pagat, të cilat janë të deklaruara dhe lehtësisht të verifikueshme.

6.4 Përfundimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz”, është i pasaktë dhe nuk mbështetet në ligj, në analizën financiare dhe në prova. Në kundërshtim me sa konkludon Komisioni, subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, ka deklaruar shkëmbimin e automjetit tip “Mercedes Benz” me automjetin tip “Volkswagen Passat”.

6.5 Mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit i dhënies së shumës 50.000 euro shoqërisë “{***}” ShPK, nuk ka pasur si qëllim fshehjen e këtij veprimi, pasi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen e kredisë në këtë shumë dhe marrëveshjen e lidhur me shoqërinë e ka depozituar në ILDKPKI. Subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të mjaftueshme për të përballuar plotësisht këtë veprim financiar.

6.6 Konkluzioni i Komisionit se ai ka qenë në situatën e konfliktit të interesit, sepse ka shqyrtuar një padi të shoqërisë “{***}” ShPK duke qenë ende në marrëdhënie interesi me të, është një konkluzion joligjor, pasi subjekti i rivlerësimit në çdo rast ka zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, të cilat prevalojnë mbi ato të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

6.7 Likuiditetet në banka të subjektit të rivlerësimit rrjedhin nga paga e tij si gjyqtar dhe përbëjnë një pasuri të ligjshme të tij, prandaj konkluzioni i Komisionit se ai ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, sepse nuk ka deklaruar këto likuiditete, nuk është i drejtë.

6.8 Mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit i marrjes së shumës 100.000 dollarë amerikanë nga z. R. D. nuk ka qenë i qëllimshëm, por duke qenë se ky transaksion bankar nuk ka sjellë shtim apo pakësim të pasurisë, subjekti i rivlerësimit e ka menduar si të panevojshëm deklaramin. Llogaria e subjektit është përdorur vetëm për transfertën bankare dhe ai nuk ka pasur asnjë përfitim.

6.9 Në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare për të mbuluar shpenzimet e kryera në {***} nga vëllai i tij, në vitet 2006, 2007 dhe 2009, pasi këto shpenzime i janë rimbursuar nga motra e tij, por edhe po të merren të mirëqena, ai ka pasur të ardhura të ligjshme dhe plotësisht të verifikueshme, për t’i përballuar këto shpenzime.

6.10 Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur pasuri të trashëguar për ta deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, bashkëshortja nga pasuria e pretenduar, jo vetëm që nuk ka përfituar, por kjo pasuri nuk mund të jetë as objekt përfitimi, pasi duke qenë në proces legalizimi, gjithçka varet nga vendimmarrja e organit kompetent.

6.11 Mosdeklarimi nga subjekti, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, i një automjeti tip “BMW”, me targë {***}, blerë në vitin 2003, ka ardhur si pasojë e harresës dhe për asnjë qëllim tjetër, duke qenë se ky automjet është çregjistruar për shkak dëmtimi.

6.12 Përfundimi i arritur nga Komisioni në lidhje me automjetin tip “BMW”, me targë {***}, është i gabuar dhe jashtë objektit të hetimit administrativ, pasi subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prova gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, se ka pasur të drejtë ta shiste këtë automjet.

B. Për kriterin e kontrollit të figurës

6.13 Komisioni dhe DSIK-ja kanë kryer shkelje të nenit Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit “Për informacionin e klasifikuar *sekret shtetëror*”, pasi Komisioni është njohur me të dhëna që janë klasifikuar “sekret shtetëror”, duke ia lejuar DSIK-ja aksesin në këto të dhëna. Dispozitat e ligjit nr. 84/2016 nuk parashikojnë, kurrësi, që njohja me përmbajtjen e dokumentit të klasifikuar t’i refuzohet subjektit të rivlerësimit që i nënshtrohet kontrollit.

6.14 Komisioni dhe DSIK-ja kanë shkelur nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës duke shtrirë objektin e hetimit dhe duke nxjerrë përfundime jashtë objektit kushtetues të kriterit të kontrollit të figurës. Komisioni, duke mos bërë asnjë arsyetim në lidhje me veprimin ose

mosveprimin e subjektit të rivlerësimit, si dhe me faktet apo rrethanat që do të provonin se ai kishte cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, ka shkëlur detyrimin ligjor të arsytimit të vendimit.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

7. Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur ankimit nuk paraqiti prova të reja dhe në shkaqet e ankimit nuk ka pretenduar që çështja e tij të shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve, sipas rasteve të përcaktuara nga nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”).

Subjekti, pas marrjes së njoftimit për gjykimin e çështjes në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, ka paraqitur në Kolegj parashtrimet me shkrim 5 ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore¹, të cilat u shqyrtuan nga trupi gjykues së bashku me ankimin.

Gjithashtu, nga shqyrtimi i procesit të rivlerësimit në Komision, trupi gjykues nuk konstatoi shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, i cili parashikon rastet kur një gjykim administrativ në gjykatën e apelit zhvillohet në seancë gjyqësore publike.

Për sa më sipër, trupi gjykues arriti në përfundimin se nuk plotësohen kushtet e përcaktuara në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit.

Për këtë arsye, shqyrtimi i shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit u zhvillua në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit, lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

8. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se në asnjë rast nuk është përpjekur të fshihet apo të deklarohet në mënyrë të pasaktë pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 132,8 m² në Shkodër dhe se burimi i blerjes së kësaj pasurie është i ligjshëm, pasi përbëhet nga të ardhurat nga pagat, tërheqjet e kursimeve nga depozitat bankare, si dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 56,1 m² në Shkodër, të cilat padrejtësisht nuk janë konsideruar nga Komisioni, trupi gjykues konstaton sa më poshtë.

Në kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 132,8 m², zona kadastrale {***}, nr. pasurie {***}, volumi {***}, faqe {***}, Shkodër (në vijim “apartamenti me sipërfaqe 132,8 m²”), Komisioni, në vendim², ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:

(i) ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, për shkak se nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit, me sipërfaqe 132,8 m², në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit;

(ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë dhe të dytë për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 132,8 m², në shumën - 463.272 lekë për vitin 2004 dhe në shumën - 1.129.645 lekë në vitin 2005 [...];

¹ Subjekti i rivlerësimit, më datë 29.06.2020, nëpërmjet shërbimit postar, paraqiti parashtrimet me shkrim 5 ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore, të protokolluara në Kolegj me nr. {***} prot., datë 29.06.2020, parashtrime të cilat i kishte paraqitur paraprakisht edhe nëpërmjet postës elektronike me e-mail, datë 26.06.2020, të protokolluara në Kolegj me nr. {***} prot., datë 26.06.2020.

² Shih faqen 12 të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019 të Komisionit.

(iii) nuk shpjegoi bindshëm mënyrën e përdorimit të shumës 1.900.000 lekë. Ai nuk paraqiti dokumentacion ligjor justifikues që të provonte deklaratimet e tij.

9. Në kundërshtim të konkluzionit të Komisionit për deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit për shkak të mosdeklarimit të burimit të krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka pretenduar se mosdeklarimi i tij nuk ka qenë i qëllimshëm dhe se Komisioni ka gabuar kur ka arsyetuar se është shkelur neni D i Aneksit të Kushtetutës, pasi ligjvënësi ka qenë i qartë që pasaktësitë në shkrim apo harresat e qëllimshme në deklarime, që nuk sjellin pasoja tek identifikimi dhe vlerësimi i pasurisë nuk mund të jenë penalizuese për subjektin. Edhe sipas ligjit nr. 84/2016, ka pretenduar subjekti, deklarata e pasurisë së rivlerësimit është pikënisja, por jo dhe fundi i hetimit administrativ. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, nga verifikimi i deklaratës së pasurisë së rivlerësimit³, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 132,8 m². Burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti nuk e ka deklaruar as në deklaratën periodike të interesave në vitin 2005⁴ dhe as në deklaratën e vitit 2004, në të cilën ka deklaruar pagimin e vlerës 1.500.000 lekë dhe 5.000 USD si “paradhënie për blerje shtëpie”.
10. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues arsyeton se, bazuar në pikat 1 dhe 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të dorëzojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin, me qëllim që t’i nënshtrohet kontrollit të pasurisë, për të verifikuar nëse ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose nëse i ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur. Ligji nr. 84/2016, në nenet 30, 31, pika 1, dhe 32, pika 1 përcakton detyrimin e subjektit të rivlerësimit jo vetëm të deklarojë pasuritë dhe burimin e krijimit të tyre, por edhe të paraqesë të gjitha dokumentet që justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Edhe formulari i deklarimit të pasurisë së rivlerësimit [shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016], në faqen 3, ka sqaruar se mosplotësimi i saktë dhe me vërtetësi i deklaratës së pasurisë mund të passjellë shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016. Vlerësimi i mjaftueshmërisë së burimeve të subjektit të rivlerësimit për të krijuar pasuritë, për efekt të kontrollit në procesin e rivlerësimit, fillon me verifikimin e burimit ligjor e më pas financiar, që subjekti ka detyrimin të deklarojë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në përcaktimin e elementeve të deklarimit të pamjaftueshëm, rendit në shkronjën “a” të tij detyrimin për saktësinë e deklarimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë në deklaratat periodike, deklarimi për efekt të procesit të rivlerësimit merr një vlerë të posaçme, si baza e vetme e informacionit, mbi të cilin do të fillojë hetimi administrativ. Në mungesë të deklarimit të burimit edhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, identifikimi i burimit dhe më tej vërtetimi i saktësisë së tij mbetet objekt i hetimit administrativ. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues vlerëson se me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 132,8 m².
11. Në shqyrtim të pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit të ngritur në ankim, se burimi i

³ Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, të dorëzuar në ILDKPKI, më datë 28.01.2017, subjekti ka deklaruar: “Apartament banimi me sipërfaqe 132,8 m², zona kadastrale {***}, nr. pasurie {***}, volumi {***}, faqe {***}, Bashkia Shkodër, rruga “{***}”, Shkodër, Shqipëri. Blerë më 27.03.2005. Vlera 4.355.840 lekë. Pjesa në %: 50%”.

⁴ Në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2005, subjekti ka deklaruar: “Apartament, Zona kadastrale {***}, nr. pasurie {***}, volumi {***}, faqe {***}, sipërfaqe 132,8 m². Pasuri e shtuar. Vlera 5.000.000 lekë. Pjesa në %: 50%”.

krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 132,8 m² është i ligjshëm, pasi përbëhet nga të ardhurat nga pagat, tërheqjet e kursimeve nga depozitat bankare, si dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 56,1 m² në Shkodër, të cilat padrejtësisht nuk janë konsideruar nga Komisioni, trupi gjykues konstaton si më poshtë.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, në cilësinë e aktit juridik që ka shërbyer, sipas tij, për krijimin e kësaj pasurie, kontratë e shitblerjes së pasurisë apartament me sipërfaqe 132,8 m² me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.03.2005, e lidhur mes subjektit të rivlerësimit e bashkëshortes së tij në cilësinë e blerësit dhe z. B. F. në cilësinë e shitësit [përfaqësues me prokurë të posaçme i bashkëpronarëve P.], në nenin 4 të saj, palët kontraktuese kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së apartamentit të jetë në vlerën 4.355.840 lekë, shumë e cila është likuiduar totalisht nga blerësi dhe pala shitëse ka pranuar se e mori tërë shumën, pa asnjë pretendim për të.

Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, por edhe në ankim, subjekti, në lidhje me pagesën e vlerës 4.355.840 lekë për blerjen e apartamentit, ka pretenduar se ajo është paguar në dy këste, përkatësisht në dhjetor 2004 dhe dhjetor 2005.

Në analizë të fakteve të sipërcituara, trupi gjykues arrin në përfundimin se vlera 4.355.840 lekë për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 132,8 m² është shlyer plotësisht nga subjekti dhe bashkëshortja e tij deri në datën 27.03.2005, datë në të cilën është lidhur kontrata e shitblerjes.

Deklarimi i subjektit e bashkëshortes së tij në kontratën e shitblerjes së pasurisë, përpara noterit publik, bazuar në nenin 690 të Kodit Civil, i cili përcakton se “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët.”, i lidhur me nenin 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton se “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre”, merr vlerë provuese në raport me deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ se pagesa e çmimit është shlyer deri në dhjetor 2005. Këtë përfundim, trupi gjykues e mbështet edhe në faktin se kjo pasuri është regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër (në vijim “ZVRPP Shkodër”), në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, më datë 06.05.2005⁵, fakt ky që thellon bindjen se shitësi e ka marrë tërësisht vlerën e parashikuar në kontratë, në momentin që ka pranuar të humbasë të drejtën e pronësisë mbi këtë apartament.

12. Duke u mbështetur në përfundimin e arritur më sipër, se vlera e apartamentit me sipërfaqe 132,8 m² është shlyer plotësisht nga subjekti dhe bashkëshortja e tij deri në datën 27.03.2005, trupi gjykues verifikoi burimet e ligjshme në dispozicion të subjektit deri në këtë datë, në raport me pretendimet e tij të shprehura në ankim.

Në lidhje me pretendimin e subjektit se shuma prej 1.900.000 lekësh, e përfutur nga shitja e një apartamenti në pronësi të tij, ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 132,8 m², trupi gjykues, nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, konstaton faktet si në vijim.

Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.07.2005, i ka shitur z. P. Ç. apartamentin 56,1 m², nr. pasurie {***}, zona kadastrale {***}, Shkodër, për vlerën prej 1.900.000 lekësh, e përcaktuar si çmim i shitblerjes së pasurisë dhe që është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale⁶ ku është lidhur kjo kontratë.

Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga ZVRPP Shkodër⁷, apartamenti me sipërfaqe 56,1 m² është regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme në emër të subjektit të rivlerësimit më datë 26.04.2005 dhe pas lidhjes së kontratës së shitblerjes si më sipër, pasuria është regjistruar në emër të blerësit P. Ç., më datë 17.08.2005.

⁵ Siç rezulton nga informacioni i përcjellë në Komision nga ZVRPP Shkodër me shkresën nr. {***} prot., datë 20.04.2018.

⁶ Paragrafi 4 i kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.07.2005.

⁷ Informacioni i përcjellë në Komision nga ZVRPP Shkodër me shkresën nr. {***} prot., datë 20.04.2018.

13. Bazuar në këtë situatë faktike, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, referuar datës së regjistrimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 56,1 m² në regjistrin e pasurive të paluajtshme, subjekti i rivlerësimit nuk mund të hynte në marrëdhënie kontraktore për shitjen e kësaj pasurie përpara datës 26.04.2005⁸ dhe subjekti i rivlerësimit nuk provoi që shumë prej 1.900.000 lekësh ta ketë para kësaj date. Në kushtet kur kontrata e shitblerjes së apartamentit me sipërfaqe 132,8 m² është lidhur më datë 27.03.2005, trupi gjykues arrin në përfundimin se shuma prej 1.900.000 lekësh nuk mund të shërbente si burim krijimi për këtë pasuri, pasi subjekti i rivlerësimit nuk e dispononte ende këtë sasi parash në momentin e lidhjes së kësaj kontrate.

Fakti i provuar më sipër, që shuma prej 1.900.000 lekësh e deklaruar gjatë hetimit administrativ dhe e pretenduar në ankim nga subjekti, nuk ka shërbyer si burim krijimi i pasurisë apartament 132,8 m², mbështetet edhe në një dokument tjetër, siç është deklarata periodike e interesave e vitit 2005, sipas së cilës rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 56,1 m², por nuk ka deklaruar se të ardhurat e përfituara i ka përdorur si burim krijimi për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 132,8 m².

Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues çmon se me të drejtë Komisioni, në analizën financiare të kryer me qëllim verifikimin e mundësisë së subjektit për të blerë me burime të ligjshme apartamentin me sipërfaqe 132,8 m², nuk ka përllogaritur shumë prej 1.900.000 lekësh të pretenduar nga subjekti si burim financiar i ligjshëm, për pagimin e kështit të dytë për blerjen e apartamentit 132,8 m².

14. Për sa i përket pagesës së kështit të parë për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 132,8 m², subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se pagesa e apartamentit është bërë në dy vite, një kësht në fund të vitit 2004 dhe fillim viti 2005, i pasqyruar në deklarin e bërë për vitin 2004, pasi deklarata është plotësuar më 31.03.2005 dhe diferenca [kështi i dytë] në dhjetor 2005. Subjekti ka pretenduar se fillimisht, ai dhe bashkëshortja kanë paguar rreth 1.500.000 lekë dhe 5.000 USD, burimi i të cilave ka qenë tërheqja nga Tirana Bank e vlerës prej 1.033.321 lekë dhe tërheqja nga Banka Kombëtare Tregtare (në vijim "BKT") e shumës 5.000 USD, ndërsa diferenca është mbuluar me kursime.

Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, konstatohet se kjo e fundit në datën 28.10.2002 ka depozituar në Tirana Bank, në llogarinë numër {***}, vlerën 460.000 lekë, vlerë të cilën në të njëjtën datë e ka kaluar në depozitën me afat numër {***}, përsëri në emër të saj. Vlerës 460.000 lekë i janë shtuar interesat bankare dhe në datën 05.01.2005, depozita është maturuar duke arritur vlerën 533.321 lekë, të cilën bashkëshortja e subjektit e ka kaluar në llogarinë e mëparshme të saj numër {***}. Në datën 05.01.2005, nga kjo llogari, bashkëshortja e subjektit ka tërhequr shumë 500.000 lekë, duke lënë gjendje vlerën 33.321 lekë. Si rezultat i këtyre veprimeve bankare, rezulton se bashkëshortja e subjektit ka tërhequr nga llogaria bankare në Tirana Bank në datën 05.01.2005, vetëm shumë 500.000 lekë, në kundërshtim me sa pretendon subjekti se ajo, në këtë datë, ka tërhequr shumë 1.000.000 lekë. Shumë 5.000 USD, bashkëshortja e subjektit e ka tërhequr nga llogaria e depozitës në BKT, me numër llogarie {***}, në datën 10.01.2005.

Në analizë të kësaj situatë faktike, trupi gjykues arrin në përfundimin se me të drejtë Komisioni nuk i ka përllogaritur vlerat e tërhequra nga llogaritë bankare nga bashkëshortja e subjektit, në analizën financiare të vitit 2004, por i ka konsideruar në atë të vitit 2005.

Duke u mbështetur në faktin se pagesën për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 132,8 m², subjekti i rivlerësimit e ka kryer deri në datë 27.03.2005, trupi gjykues vlerëson se verifikimi

⁸ Bazuar në nenin 195 të Kodit Civil, i cili përcakton se "Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato që janë fituar ose njohur sipas dispozitave të këtij Kodi, nuk mund të tjetërsohen dhe kur është rasti, të ngarkohen me barrë, në rast se nuk është bërë regjistrimi i tyre në regjistrat publikë".

i ligjshmërisë së burimeve financiare të subjektit për blerjen e kësaj pasurie duhet të ishte kryer nga Komisioni për periudhën 01.01.2005 - 27.03.2005.

15. Trupi gjykues i Kolegjit verifikoi mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 132,8 m². Pas kryerjes së analizës financiare, duke reflektuar në përlllogaritje qëndrimet e mbajtura nga trupi gjykues ndaj pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, të shprehura në paragrafët e mësipërm të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 132,8 m², për periudhën 01.01.2004 - 27.03.2005, në vlerën 3.154.379 lekë. Trupi gjykues çmoi të pranojë si të provuar mungesën e burimeve të ligjshme të subjektit dhe të personit të lidhur me të në shumën 1.592.917 lekë, shumë kjo e evidentuar nga Komisioni, në kushtet kur vlera e mungesës së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të, e përfutur si rezultat i analizës financiare të kryer mbi reflektimin e arsytimit të trupit gjykues, është shumë më e lartë.
16. Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se për pasurinë apartament me sipërfaqe 132,8 m², subjekti i rivlerësimit:
- a) ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;
 - b) ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e këtij apartamenti, siç parashikohet në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.***
17. *Lidhur me pretendimin se apartamenti i banimit me sipërfaqe 56,1 m² në Shkodër është përfutur prej subjektit të rivlerësimit në përputhje me legjislacionin e kohës që rregullonte të drejtën e përfutimit të banesave për familjet e pastreha, nëpërmjet lidhjes së një kontrate me Entin Kombëtar të Banesave, si dhe se Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti nuk provoi me dokumentacion provues se i takonte të përfutonte strehim nga Enti Kombëtar i Banesave, duke bërë një arsyetim jashtë objektit ligjor të punës së tij, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë apartament banimi me sipërfaqe 56,1 m², zona kadastrale {***}, nr. pasurie {***}, volumi {***}, faqe {***}, Shkodër (në vijim “apartamenti me sipërfaqe 56,1 m²”), në vendim⁹ ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:*
- (i) *ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi duke mos deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit të ardhurat në shumën 1.900.000 lekë, të përfuturara nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 56,1 m²;*
 - (ii) *nuk provoi me dokumentacion provues se atij i takonte të përfutonte shumën prej 800.000 lekësh nga Enti Kombëtar i Banesave në përputhje me legjislacionin në fuqi të kohës.*
18. Në kundërshtim të konkluzioneve të mësipërme të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se shumën prej 800.000 lekësh e ka përfutur në përputhje me legjislacionin në fuqi të kohës, sipas të cilit procesi i vlerësimit dhe mbledhjes së dokumentacionit bëhej nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim “EKB”) dhe subjekti përfutues nuk kishte asnjë mundësi ligjore të ndërhynte në këtë proces. Subjekti i rivlerësimit, gjithashtu, pretendon se analiza dhe arsyetimi i Komisionit është vlerësim i punës dhe veprimtarisë së EKB-së, jashtë objektit ligjor të procesit të rivlerësimit.
19. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, u morën në shqyrtim dhe u vlerësuan nga trupi gjykues, rrethanat në të cilat kanë ndodhur faktet lidhur me krijimin e kësaj pasurie, duke analizuar sjelljen dhe ndërveprimin e subjektit të rivlerësimit në raport me

⁹ *Shih faqen 12 të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit.*

mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie. Në këtë kuadër, trupi gjykues vëren në mënyrë të përmbledhur sa më poshtë.

20. EKB-ja ka përcjellë në Komision¹⁰ dokumentacionin e plotë të shitjes së apartamentit 56,1 m² në Shkodër, sipas të cilit, më datë 25.10.1996, dega e EKB-së Shkodër ka lidhur “Kontratë të përkoreshme për shitje apartament banimi” me subjektin e rivlerësimit, për shitjen e një apartament banimi me përbërje një dhomë dhe një kuzhinë.

Kontrata përfundimtare për shitjen e apartamentit është lidhur në vitin 2001, sipas aktit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.12.2001, “Kontratë shitje apartament banimi me pagesë të menjëhershme”, të lidhur ndërmjet Drejtorisë Rajonale të EKB-së Shkodër, në cilësinë e palës shitëse, dhe A., E., Ç., L., T., D. dhe Z. Z., në cilësinë e palës blerëse. Sipas kësaj kontrate, apartamenti me sipërfaqe 56,1 m², i ndërtuar me fonde shtetërore, ka vlerën 854.007 lekë. Blerësit i takon shuma e përfitimit falas në bazë të legjislacionit në fuqi, në vlerën 800.000 lekë, ndërsa detyrimi financiar i paguar prej tij është 88.167 lekë¹¹.

Në praktikën e përcjellë nga EKB-ja gjenden edhe:

a) certifikata familjare e familjes me kryefamiljar E. Z., sipas gjendjes familjare të vitit 1992, në të cilën figurojnë E., Ç., L., T., D., A., Z. dhe A. Z., e lëshuar “Për efekt të përfitimit nga shteti i familjeve të pastreha”¹²;

b) Formulari nr. 10 i EKB-së, rrethi Shkodër, me titull “Llogaritja e çmimit të apartamentit nr. {***}, banesa nr. {***}, “{***}”, blerësi Arben Zefi”;

c) Vërtetim i Bashkisë Shkodër nr. {***} prot., datë 05.01.2000, sipas të cilit vërtetohet se z. Arben E. Zefi ka statusin e të pastrehëve në grupin {***}, me nr. rendor {***}, sipas vendimit të Këshillit Bashkiak nr. {***}, datë 14.10.1999;

ç) Vërtetim i Bashkisë Shkodër nr. {***} prot., datë 21.12.2001, sipas të cilit vërtetohet se z. E. Z. nuk ka përfituar nga ligji nr. 7652, datë 25.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”;

d) Vërtetim nga Ndërmarrja e Banesave, datë 12.01.2000, sipas të cilit z. Arben Zefi nuk ka përfituar nga ligji nr. 7652, datë 25.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”.

Nga informacioni i përcjellë në Komision nga ZVRPP Shkodër me shkresën nr. {***} prot., datë 20.04.2018, konstatohet se nëpërmjet “Akt heqje dorë nga pasuria e paluajtshme” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.01.2002, bashkëpronarët E., Ç., L., T., D. dhe Z. Z. kanë hequr dorë nga pjesa e tyre takuese ideale e pandarë 1/7 mbi pasurinë apartament me sipërfaqe 56,1 m², duke e kaluar në favor të bashkëpronarit Arben Zefi. Ky akt është regjistruar në ZVRPP Shkodër më datë 26.04.2005.

21. Arsyetimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka përfituar shumë prej 800.000 lekësh, në kundërshtim me ligjin nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, mbështetet në deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ se: *Motra, L. Z., është ndarë nga familja për shkak të martesës në vitin 1987 dhe ka jetuar në {***} në një shtëpi private të ndërtuar nga ajo dhe bashkëshorti. Vëllai, D. Z., është martuar në vitin 1992, fillimisht ka jetuar bashkë me familjen tonë dhe nga viti 2006 ka jetuar bashkë me bashkëshorten dhe fëmijët në Shëngjin [...]. Motra T. është ndarë nga familja për shkak të martesës në vitin 1992 dhe jeton në fshatin {***}, Lezhë, bashkë me bashkëshortin dhe fëmijët e saj në një banesë private të ndërtuar prej tyre. Pas blerjes së apartamentit, prindërit kanë jetuar me mua dhe me vëllain A., i cili në tetor 1996 filloi shërbimin e detyruar ushtarak, ndërsa motra Z. ka jetuar në Itali për shkak të studimeve. Sipas arsyetimit të Komisionit, familjarët e subjektit të rivlerësimit të përfshirë në llogaritjen e EKB-së nuk kanë qenë anëtarë të familjes së tij dhe rrjedhimisht ata nuk mund të përfshiheshin në llogaritjen e shumës që do të përfitonte subjekti i rivlerësimit në zbatim të legjislacionit në fuqi, por edhe*

¹⁰ Me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 10.04.2018.

¹¹ Sipas paragrafit me titull “Vlefata e apartamentit dhe çmimi i shitjes” i “Kontratë shitje apartament banimi me pagesë të menjëhershme” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.12.2001.

¹² Sipas shënimit në këtë certifikatë.

sepse bazuar në deklaramet e subjektit të rivlerësimit dy prej motrave të tij kanë pasur shtëpi banimi për shkak të martesës dhe madje njëra prej tyre edhe truall në pronësi.

22. Në analizë të këtij arsyetimi të Komisionit, në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, situatën faktike si më sipërcituar, si dhe me legjislacionin në fuqi të kohës që rregullonte kontributin e shtetit për familjet e pastreha, trupi gjykues konstaton se ligji i kohës nr. 8030, datë 15.11.1995, "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", në nenin 2 të tij përcaktonte se çdo familje e pastrehë përfiton falas të drejtën për të shpenzuar një shumë parash, në varësi të pjesëtarëve të familjes dhe moshës së tyre. Përkufizimi i "të pastrehëve" është bërë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 49, datë 29.01.1993, sipas pikës 1 të të cilit quhen "të pastrehë" qytetarët të cilët nuk kanë kontratë me ndërmarrjen komunale të banesave; janë me banim të përkohshëm në ndërtesa që nuk hyjnë në fondin e banesave, si konvikte, shkolla etj.; banojnë në ndërtesa që nuk përmbushin kushtet higjieno-shëndetësore; banojnë në banesa shtetërore ish-pronë private, si dhe ata që janë qiramarrës në banesa private, si dhe ata që si pasojë e vendimeve gjyqësore rezultojnë me strehim të përkohshëm. Sipas pikës 2 të po këtij vendimi, kategoritë e qytetarëve që përfitonin statusin si të pastrehë përcaktoheshin nga këshillat e rretheve, bashkive ose komunave dhe lista e tyre depozitohej nga kryetari i rrethit ose bashkisë, pranë degës së EKB-së të rrethit përkatës.
- Mënyra e përlllogaritjes së shumës së përfitimit nga familjet e pastreha, përcaktohej në udhëzimin nr. 7, datë 16.04.1996, të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e llogaritjes së shumës së përfitimit falas për familjet e pastreha në zbatim të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995, *Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha*". Në pikën 2 të këtij udhëzimi përcaktohet se koordinatat bazë të përlllogaritjes së shumës së përfitimit për familjet e pastreha ishin numri i anëtarëve të familjes së pastrehë dhe moshja totale e të gjithë anëtarëve të saj, të dhëna të cilat rezultojnë nga certifikata e gjendjes familjare e familjes së pastrehë e datës 01.12.1992, e lëshuar për këtë qëllim. Më tej udhëzimi shpjegon formulën e përlllogaritjes së shumës së përfitimit nga fondet shtetërore.
23. Duke u kthyer në rastin konkret, siç rezultojnë nga aktet e praktikës së shitjes së apartamentit nga EKB-ja, statusi i qytetarit të pastrehë i është dhënë subjektit të rivlerësimit me vendimin nr. {***}, datë 14.10.1999, të Këshillit Bashkiak Shkodër.
- Nga formulari nr. {***} i EKB-së, rrethi Shkodër, me titull "Llogaritja e çmimit të apartamentit nr. {***}, banesa nr. {***}, "{***}", blerësi Arben Zefi", rezultojnë se shuma prej 800.000 lekësh është përlllogaritur nga dega e EKB-së Shkodër, mbi bazën e certifikatës familjare të familjes së subjektit të rivlerësimit, sipas gjendjes familjare të vitit 1992, veprim ky në përputhje me legjislacionin e sipërcituar.
24. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni, në arsyetimin e tij, është mbështetur vetëm në deklaramet e subjektit të rivlerësimit, pa ballafaquar parashikimet ligjore të kohës me dokumentacionin e gjendur në praktikën e shitjes së apartamentit 56,1 m², të përcjellë nga EKB-ja. Komisioni, bazuar në deklaramet e subjektit, ka konkluduar se motrat e subjektit kanë pasur shtëpi banimi për shkak të martesës dhe, për këtë arsye, nuk mund të përfshiheshin në llogaritjen e shumës që do të përfitonte subjekti i rivlerësimit në zbatim të legjislacionit në fuqi, mbështetur në fakte që i përkasin vitit 1996, pa hetuar se si ishte gjendja familjare e subjektit në vitin 1992 e nëse përputhej ajo me certifikatën familjare të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile {***} Lezhë, për efekt të përfitimit nga ligji nr. 8030, datë 15.11.1995 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Komisioni, pavarësisht se ka konkluduar se subjekti ka përfituar shumën 800.000 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 8030, datë 15.11.1995, "Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha", nuk ka arsyetuar dhe identifikuar se cilat kanë qenë veprimet konkrete të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë çuar në përfitimin e kësaj shume në shkelje të dispozitave ligjore, cili ka qenë ndikimi i subjektit të rivlerësimit tek organet shtetërore për t'i detyruar ato të disponojnë në shkelje të parashikimeve ligjore, cilat janë pasojat apo ndikimi i këtyre veprimeve në procesin e rivlerësimit të subjektit në lidhje me masën disiplinore të deklaramet të pamjaftueshëm, sipas

nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, trupi gjykues çmon të vlerësojë se konkluzioni se subjekti nuk provoi me dokumentacion provues se atij i takonte të përfitonte shumën prej 800000 lekësh nga Enti Kombëtar i Banesave, në përputhje me legjislacionin në fuqi të kohës, ka mbetur i paargumentuar nga Komisioni, në lidhje me efektet e tij në procesin e kontrollit të kriterit të vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe, për këtë arsye, nuk do ta konsiderojë atë si element vlerësimi për këtë kriter.

25. Konkluzionin e arritur nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, duke mos deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit të ardhurat në shumën 1900000 lekë, të përfituara nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 56,1 m², trupi gjykues e vlerëson të drejtë, pasi nga verifikimi i deklaratave periodike të pasurisë, të dorëzuara në ILDKPKI, konstaton se subjekti, në deklaratën e pasurisë së vitit 2003, ka deklaruar në pronësi të tij pasurinë apartament me sipërfaqe 56,1 m², blerë nga Enti Kombëtar i Banesave, në atë të vitit 2005 ka deklaruar shitjen e tij për vlerën 2.000.000 lekë, ndërsa në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit nuk ka deklaruar përfitimin e të ardhurave nga shitja e këtij apartamenti, në vitin 2005.

Nga verifikimi i dokumentacionit justifikues të deklarimeve në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, dorëzuar në ILDKPKI më datë 26.01.2017, konstatohet se subjekti ka dorëzuar dokumentacionin në bazë të të cilit ka përfituar apartamentin me sipërfaqe 56,1 m², si dhe kontratën e shitjes së tij. Por, pavarësisht këtij fakti, bazuar në parashikimet ligjore, subjekti kishte detyrimin për të deklaruar në deklaratë, të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë apartament me sipërfaqe 56,1 m² në vlerën 1.900.000 lekë, të cilat gjatë hetimit administrativ ka pretenduar se kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë apartament me sipërfaqe 132,8 m² në vitin 2005. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

26. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim, se konkluzioni i Komisionit për automjetin tip “BMW”, blerë në vitin 2007, nuk është i drejtë, pasi gjatë hetimit administrativ ai ka dhënë shpjegime të plota në lidhje me këtë mjet dhe ka argumentuar se pasaktësia në deklarim ka ardhur si pasojë e prezumimit të bërë prej tij, se mosdeklarimi i burimit të të ardhurave nënkupton se ato burojnë nga pagat, të cilat janë të deklaruara dhe lehtësisht të verifikueshme, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim¹³, në kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë automjet, tip “BMW”, me targë {***}, blerë në vitin 2007, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:

(i) ka bërë deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me pronësinë dhe vitin e blerjes së automjetit tip “BMW”,

(ii) ka bërë deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e automjetit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.

27. Në ankim, në kundërshtim të konkluzioneve të mësipërme të Komisionit, subjekti ka paraqitur disa pretendime. Ai ka pretenduar se bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit, ai ka paraqitur dokumentacionin që Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër (në vijim “DRShTRr”) i kishte vënë në dispozicion. Subjekti ka paraqitur para Komisionit kontratën e huapërdorjes së automjetit, e cila është paraqitur brenda një procesi administrativ, pavarësisht momentit të dorëzimit së saj, prandaj ajo duhej të merrej si provë nga Komisioni dhe jo dokumentacioni i paraqitur prej tij në ILDKPKI. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit i burimit të të ardhurave për blerjen e automjetit, ka ardhur si pasojë e prezumimit të tij se mosdeklarimi i burimit nënkupton që ai përbëhet nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, të cilat janë të ardhura të

¹³ Shih faqen 12 të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit.

ligjshme.

28. Në analizë të këtyre pretendimeve të subjektit të rivlerësimit u morën në shqyrtim dhe u vlerësuan nga trupi gjykues, aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, sipas të cilave rezultoi se:

- Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, subjekti ka deklaruar: *Makinë BMW {***}, e blerë në vitin 2007. nr. i lejes {***}, datë 07.11.2007, targë {***}.*

Bashkëlidhur kësaj deklarate, subjekti ka depozituar:

1. Vërtetim nr. {***} prot., datë 27.01.2017, i Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër, sipas të cilit automjeti me targë {***} është i regjistruar në DRShTRr Shkodër, me pronar Arben Zefi, me nr. leje {***}, datë 07.11.2007.

2. Faturë shitje automjeti “BMW {***}” me targë {***}, në gjuhën italiane, e shoqërisë “{***}” e datës 29.11.2006, ku blerës rezultoi z. Arben Zefi dhe çmimi i shitjes është në shumën 3000 euro.

3. Faturë shitje mjeti automjeti “BMW {***}” me targë {***}, në gjuhën shqipe, e shoqërisë “{***}”, e datës 29.11.2006, ku blerës rezultoi z. Arben Zefi dhe çmimi i shitjes është në shumën 3000 euro.

4. Vërtetim hyrje e Doganës {***}, për automjetin tip “BMW” me targë {***}, datë 24.09.2007, në emër të z. Arben Zefi.

5. Mandatpagese i Bankës së Bashkuar Shqiptare (në vijim “UBA”), datë 25.09.2007, paguar nga z. Arben Zefi, për Degën e Doganës Shkodër, në shumën 173.928 lekë.

6. Mandatpagese i UBA-s, datë 25.09.2007, paguar nga z. Arben Zefi, për Degën e Tatimeve Shkodër, në shumën 123 lekë.

7. Mandatpagese i UBA-s, datë 25.09.2007, paguar nga z. Arben Zefi, për Degën e Tatimeve Shkodër, në shumën 141.375 lekë.

8. Mandatpagese i UBA-s, datë 25.09.2007, paguar nga z. Arben Zefi për komision bankar, në shumën 300 lekë.

- Nga informacioni i përcjellë në Komision nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRr”) gjatë hetimit administrativ¹⁴, nga dosja e automjetit tip “BMW”, me targë {***}, rezultoi se automjeti është në statusin çregjistrim i përhershëm nga data 31.12.2017, por ka qenë në pronësi të z. Arben Zefi, me datë regjistrimi 07.11.2007.

- Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni në lidhje me çmimin e këtij mjeti, pasi në faturën e shitjes së shoqërisë “{***}.” e datës 29.11.2006, rezultoi në vlerën 3000 euro, ndërsa në deklaratën doganore Import 4 është deklaruar në vlerën 5845 euro, subjekti është përgjigjur në mënyrë të përmbledhur se autovetura “BMW {***}” është marrë në huapërdorje në vitin 2006, me premtimin për shitje nga një shtetas kosovar me emrin Sh. H., të cilin e kishte kontaktuar vëllai i tij, z. D. Z.. Kontrata e huapërdorjes është bërë pas dhënies së shumës 3000 euro z. Sh. H., ndërsa kontrata e shitjes do të bëhej pasi ai të sillte çregjistrimin e mjetit nga Kosova. Pas një viti nga përdorimi i mjetit dhe me gjithë dështimet për të kontaktuar me pronarin e mjetit, vëllai, z. D. Z., i ka sjellë mjetin me të gjitha dokumentet e rregullta, leje qarkullimi, siguracion dhe të treguar. Subjekti deklaroi se e ka përdorur normalisht mjetin dhe madje ka udhëtuar jashtë territorit të Shqipërisë me këtë mjet duke iu nënshtruar regjimit kufitar të kontrollit, për këtë arsye nuk kishte as më të voglin dyshim se mjeti, zhdoganimi apo targimi i tij mund të kishin problem. Këtë mjet ai ia ka dhënë në huapërdorje vëllezërve A. dhe S. Z., sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.04.2010. Më datë 21.09.2010, nga ana e policisë së Drejtorisë së Qarkut Shkodër është bllokuar mjeti me targë {***}, që e drejtonte z. A. Z., me dyshimin se ishte i vjedhur. Pas sekuestrimit të mjetit me vendim të prokurorit, më datë 22.09.2010, subjekti deklaroi se nuk e ka përdorur më mjetin.

¹⁴ Informacioni i përcjellë në Komision nga DPSHTRr me shkresën nr. {***} prot., datë 05.04.2018.

- Në dosjen e procedimit penal nr. {***}, viti 2010, e paraqitur nga subjekti në Komision gjatë hetimit administrativ, gjendet akti “Procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale”, datë 04.10.2010, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit është paraqitur me kërkesë të tij në Prokurorinë e Rrethit Shkodër dhe ka deklaruar se: “Mjeti tip “BMW” me targë {***}, që prej vitit 2006 është në pronësinë time. Unë mjetin fizikisht nuk e kam blerë vetë, por është vëllai im D. Z., i cili ka kontaktuar me pronarin e mjetit dhe pasi ai ka marrë përsipër se mjeti është i rregullt dhe pasi kanë rënë dakord lidhur me çmimin është bërë blerja fizike e mjetit. [...] vëllai im mjetin e ka marrë duke përpiluar një kontratë huapërdorje për të përdorur mjetin deri në sjelljen nga ana e Sh. H. pronarit të mjetit, të dokumenteve për çregjistrimin e mjetit. Kontrata e huapërdorjes është përpiluar në emrin tim [...] para noterit A. K., në muajin tetor të vitit 2006 [...] Në këto kushte, pas një kohe rreth një vit e gjysmë, vëllai im më ka kërkuar pasaportën duke më thënë se do bënte dokumentet e mjetit. Të nesërmen, [...] vëllai më ka sjellë pasaportën [...] dhe më tha se kontratën nuk e kishte bërë, pasi nuk erdhi Sh.. Pas disa ditësh, [...] vëllai më tha se kishte bërë dokumente të rregullta të mjetit dhe se lejen e qarkullimit e kishte bërë në emrin tim. Për rreth tre vjet, unë e kam përdorur këtë mjet, duke lëvizur brenda e jashtë Shqipërisë dhe asnjëherë nuk kam pasur ndonjë sinjal ose dyshim lidhur me burimin e pronësisë së tij. [...] Jam i vetëdijshëm që për shkak të shmangies së pronarit të ligjshëm, shtetasit kosovar, vëllai im në përpilimin e targimit të mjetit ka kryer veprime jo të ligjshme dhe tani që jam njohur me dosjen e targimit të mjetit konstatoj se ka akte të cilat nuk janë reale, pra janë të falsifikuara. Kështu është plotësisht i falsifikuar akti i titulluar “Vërtetim hyrje mjeti”, i cili rezulton në emrin tim”.

- Më datë 04.10.2010, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka sekuestruar provën shkresore “Kontratë huapërdorje” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.10.2006, të lidhur mes huadhënësit Sh. H. dhe huamarrësit Arben Zefi, sipas së cilës huadhënësi i jep në përdorim huamarrësit, një automjet tip “BMW” {***}, pa shpërblim dhe për një periudhë kohore pa përcaktim, që ta përdorë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

- Nga përmbajtja e vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. {***}, datë 11.02.2011, i paraqitur në Komision nga subjekti gjatë hetimit administrativ, rezulton se vëllai i tij, z. D.Z., është deklaruar fajtor për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Gjykata, në vendim, ka arsyetuar se i pandehuri D.Z., veprën penale e ka kryer me anë të falsifikimit të dokumenteve me qëllim targimin e automjetit tip “BMW”, me targë {***}, duke përdorur pasaportën e të vëllait Arben Zefi, veprime të kryera me dashje nga ana e tij.

29. Në analizë të situatës faktike të pasqyruar si më sipër në këtë vendim, në funksion të vlerësimit të shkaqeve të ankimit që lidhen me këtë pasuri, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit se bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin që Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër i ka vënë në dispozicion, nuk bazohet në aktet e përcjella nga vetë ai në ILDKPKI, pasi nga verifikimi i vërtetimit nr. {***} prot., datë 27.01.2017, i Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër, rezulton se ky institucion ka vërtetuar se z. Arben Zefi është pronar i autoveturës tip “BMW” {***}, me nr. leje {***}, datë 07.11.2007, por pa u shprehur për dhënie dokumentacioni bashkëlidhur këtij vërtetimi. Ky fakt i konstatuar edhe nga Komisioni, i ka shërbyer këtij të fundit për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me pronësinë e automjetit tip “BMW”, me targë {***}. Por, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar vetëm lejen e qarkullimit të datës 07.11.2007, të dhëna që përputhen me ato të përcjella nga DPShTRr me shkresën nr. {***} prot., datë 05.04.2018, sipas së cilës automjeti tip “BMW”, me targë {***}, ka qenë në pronësi të subjektit të rivlerësimit deri në datën 31.12.2017, datë e çregjistrimit të përhershëm të mjetit.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se Komisioni nuk duhet të kishte konkluduar se

subjekti ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me pronësinë e automjetit tip “BMW”. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti, duhet të kishte deklaruar të gjitha veprimet juridike të kryera me pasurinë automjet tip “BMW”, duke filluar nga kontrata e marrjes në huapërdorje, pagimi i shumës 3000 euro, regjistrimi, sekuestrimi e deri te dhënia më pas në huapërdorje te persona të tretë, për më tepër që këtë pasuri ai e ka deklaruar në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”. Ky detyrim i subjektit buron jo vetëm nga parashikimet kushtetuese, por edhe nga kërkesat e deklaratës së pasurisë së rivlerësimit¹⁵, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklarojnë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej pasurive dhe të drejtat reale mbi to, të cilat ndodhen në pronësi, posedim ose në përdorim, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre. Subjekti, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, duhet të kishte deklaruar rrethanat faktike të kësaj pasurie, për të cilat ai ka qenë në dijeni të plotë, duke shfaqur vullnetin e tij për deklaram të saktë e duke mos e lënë zbulimin ose jo të tyre në kuadër të hetimit administrativ, me qëllim shmangien e përgjegjësisë disiplinore për deklaram të pasaktë në kundërshtim me ligjin.

30. Në lidhje me pretendimin tjetër të subjektit se ka paraqitur para Komisionit kontratën e huapërdorjes së mjetit, e cila duhej të merrej si provë dhe jo dokumentacioni i paraqitur prej tij në ILDKPKI, trupi gjykues vlerëson se edhe ky pretendim i subjektit nuk është i bazuar, pasi Komisioni, në vendim, ka arsyetuar se: *Deklarami i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit në lidhje me vitin e blerjes (2007) nuk përputhet me deklaramet e tij gjatë hetimit administrativ (deklarohet vit blerje 2006)*, si dhe në analizën financiare ka përlllogaritur si vlerë të paguar për automjetin tip “BMW” shumën 3.000 euro. Por trupi gjykues arsyeton se Komisioni nuk duhet të kishte arritur në përfundimin se *subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me vitin e blerjes së automjetit tip “BMW”*, pasi ky konkluzion nuk mbështetet në situatën faktike. Subjekti i rivlerësimit, në asnjë rast, nuk ka deklaruar se ka kryer blerje të automjetit dhe nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të provuar këtë fakt. Edhe aktet e paraqitura prej tij pranë ILDKPKI-së, sipas vendimit penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. {***} datë 11.02.2011, rezultuan se ishin të falsifikuara. Kontrata e huapërdorjes së këtij mjetei nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.10.2006, e lidhur mes huadhënësit Sh. H. dhe huamarrësit Arben Zefi, nuk mund të konsiderohet si kontratë shitblerjeje, pavarësisht se subjekti e ka poseduar mjetin që nga kjo datë dhe ka pretenduar se ka paguar vlerën 3.000 euro për të garantuar blerjen e mëvonshme të tij. Në këto kushte, Komisioni mund të konkludonte vetëm në lidhje me mosdeklarimin nga ana e subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, të vitit të kryerjes së pagesës dhe vlerës së saj.
31. Në analizë të pretendimit të subjektit se *nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e automjetit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit*, si pasojë e prezumimit të tij se mosdeklarimi i burimit nënkupton që ai përbëhet nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, trupi gjykues i mbetet vlerësimit se subjekti nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për deklarimin e burimit të krijimit të pasurisë automjet tip “BMW”, që e bën të drejtë konkluzionin e Komisionit si më sipër. Mosdeklarimi nga subjekti në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, të burimit ligjor dhe burimit të të ardhurave për krijimin e kësaj pasurie, i parë në raport me ekzistencën e gjithë problematikës së regjistrimit të kësaj pasurie në regjistrat publikë, e provuar me një vendim gjyqësor, si dhe me faktin e mosdeklarimit nga subjekti, fillimisht të përdorimit dhe më pas të regjistrimit të kësaj pasurie, në deklaratat e interesave periodikë në vite, dëshmon një përpjekje të subjektit për të mosdeklaruar saktësisht këtë pasuri. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit, ashtu siç edhe vetë ka pranuar gjatë hetimit administrativ në Komision, është hetuar nga ILDKPKI-ja në kontrole të mëparshme të pasurisë dhe i është tërhequr vëmendja për deklaram të pasaktë, çka duhet ta bënte atë të tregonte një kujdes të

¹⁵ Shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016.

shtuar në plotësimin e deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, për të shmangur çdo pasaktësi në deklaram.

32. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë automjet tip “BMW”, si dhe vlerën e paguar për këtë pasuri, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

33. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se përfundimi i Komisionit se ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz”, si dhe nuk ka deklaruar shkëmbimin e automjetit tip “Mercedes Benz” me automjetin tip “Volkswagen Passat”, është i pasaktë dhe nuk mbështetet në ligj, në analizën financiare dhe në prova, trupi gjykues vëren se në kontrollin dhe vlerësimin e pasurive automjet tip “Mercedes Benz”, me targë {***} dhe automjet tip “Volkswagen Passat”, me targë {***}, Komisioni, në vendim¹⁶, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:

(i) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz”;

(ii) ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk ka deklaruar shitjen/shkëmbimin e automjetit tip “Mercedes Benz” me automjetin tip “Volkswagen Passat”;

(iii) shkëmbimi i automjeteve i kryer nga subjekti i rivlerësimit përbën një veprim financiar të pajustificuar dhe të pambështetur në parimet e ekonomisë së tregut (parimi i fitimit), përderisa shitësi shet me një çmim më të ulët mallin e sapoblerë.

34. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit sipas të cilit Komisioni ka gabuar lidhur me konsiderimin si deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin të mosdeklarimit prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit të shkëmbimit të automjetit tip “Mercedes Benz” me automjetin tip “Volkswagen Passat”, nga shqyrtimi gjyqësor i akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstaton situatën faktike si vijon.

• Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, bashkëshortja e subjektit, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, ka deklaruar: “Mercedes Benz {***}, e ndërruar dhe transferuar në Durrës, 29.10.2014, por e paçregjistruar akoma nga pronësia ime. Blerë më datë 22.09.2009, me kontratë nr. {***} rep., nr. {***} kol. Leja {***}, datë 03.07.2014, targë {***}. Huapërdorje Volkswagen Passat, targë {***}, A. H.. Prokurë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.08.2014”.

• Me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2009, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. I. S., ka blerë nga znj. D. G., automjetin tip “Mercedes Benz”, në vlerën 500.000 lekë, e cila është likuiduar tërësisht në datën e lidhjes së kontratës¹⁷.

Sipas aktit “Prokurë e posaçme” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.08.2014, z. A. H. i ka dhënë znj. I. S. tagër dhe kompetencë të plotë të përdorë automjetin tip “Volkswagen Passat” në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të paguajë çdo lloj takse dhe siguracioni për këtë mjet, si dhe të përgjigjet për të gjitha detyrimet financiare në lidhje me të.

• Nga informacioni i përcjellë në Komision nga DPSHTR¹⁸, rezulton se automjeti tip “Mercedes Benz” është në pronësi të znj. I. S., ndërsa automjeti tip “Volkswagen Passat” është në pronësi të z. A. H.. DRShTRr Shkodër, me vërtetimin nr. {***}, datë 28.10.2014

¹⁶ Shih faqen 22 të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit.

¹⁷ Neni III i kontratës së shitblerjes, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2009.

¹⁸ Informacion i përcjellë në Komision me shkresat nr. {***} prot., datë 05.04.2018 dhe nr. {***} prot., datë 25.05.2018.

vërteton çregjistrimin e automjetit tip “Mercedes Benz”, bazuar në kërkesën nr. {***}, datë 28.10.2014, e paraqitur nga znj. A. R. pranë DRShTRr Durrës, për transferimin e dosjes dhe kartelës së mjetit, si dhe për ekstradimin e tij në Durrës.

- Noteri P. B., me shkresën e datës 04.04.2018, ka vënë në dispozicion të Komisionit aktin e redaktuar prej tij “Revokim kontrate” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.11.2014, sipas të cilit palët, znj. I. S. dhe znj. A. R., kanë deklaruar se, duke revokuar kontratën e shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.10.2014, automjeti tip “Mercedes Benz” mbetet në pronësi të shitëses, znj. I. S..

- Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka deklaruar¹⁹: “Arsyeja e revokimit të kontratës së shitjes së automjetit Mercedes Benz është se blerësi gjeti një makinë tjetër dhe në kontakt me z. A. H., ky i fundit na tha se po gjej unë një makinë familjare dhe rregullohem me makinën që ke, nëpërmjet shkëmbimit. [...] Z. A. H. ka licencë për tregtim makinash dhe ka njohuri në këtë fushë, pronar i “{***}” ShPK. Arsyeja e deklarimit se automjeti është ndërruar dhe transferuar në Durrës më datë 18.10.2018, por pa e çregjistruar akoma nga pronësia e bashkëshortes, është se kështu është e vërteta. Z. A. H., tregtari me të cilin bëra këmbimin, nuk më solli dokumentet dhe për neglizhencë ka mbetur kështu. Mjeti Mercedes Benz është ndërruar me mjetin Volkswagen Passat.”

Bashkëlidhur këtij deklarimi, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.10.2018, në të cilën z. Arben Zefi, znj. I. S. dhe z. A. H. deklarojnë se mjetin me targë {***} në pronësi të z. A. H. dhe automjetin me targë {***} në pronësi të znj. I. S., i kanë këmbyer mjet me mjet, pa pasur nevojë për pagesa shtesë në lekë.

35. Në analizë të kësaj situatë faktike në raport me pretendimin e subjektit, trupi gjykues vëren se në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, bashkëshortja e subjektit nuk ka deklaruar vlerën e blerjes së automjetit tip “Mercedes Benz” dhe burimin e të ardhurave për blerjen e tij. Ajo ka deklaruar se e ka *ndërruar* këtë automjet, por nuk ka deklaruar se me cilin mjet. Nga hetimi administrativ ka rezultuar e provuar se automjeti tip “Mercedes Benz” ka qenë ende në pronësi të bashkëshortes së subjektit në momentin e deklarimit të pasurisë për efekt të procesit të rivlerësimit, fakt ky i pranuar edhe në deklarimin për efekt të procesit të rivlerësimit. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.10.2018, z. Arben Zefi, znj. I. S. dhe z. A. H. deklarojnë se mjetin me targë {***}, tip “Volkswagen Passat”, në pronësi të z. A.H. dhe automjetin me targë {***}, tip “Mercedes Benz”, në pronësi të znj. I.S., i kanë këmbyer mjet me mjet, por pa përcaktuar kohën kur ka ndodhur ky shkëmbim. Për këtë arsye, si datë e shkëmbimit të mjeteve, për efekt të këtij gjykimi dhe në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokument tjetër, trupi gjykues konsideron datën e nënshkrimit të kësaj deklaratë noteriale, datën 12.10.2018.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, në zbatim të nenit 3, pikat 11, 30 e 31 të ligjit nr. 84/2016 e të shtojcës 2 – deklarata e pasurisë së rivlerësimit – të këtij ligji, kishte detyrimin të deklaronte marrëdhëniet e saj me pasuritë e paluajtshme e të luajtshme, në momentin e deklarimit, në kuptim të të drejtave reale mbi to, sipas Kodit Civil. Në këtë kuptim, personi i lidhur duhet të deklaronte pronësinë mbi automjetin tip “Mercedes Benz”, vlerën e kontratës së shitblerjes së automjetit dhe burimin ligjor e financiar të krijimit të kësaj pasurie. Gjatë hetimit administrativ është provuar me dokumentacion se marrëdhënia reale e bashkëshortes së subjektit me automjetin tip “Volkswagen Passat” është ajo e huapërdorjes, siç edhe subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Për këtë arsye, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit mbi deklarimin e pasaktë të subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, por me arsyetimin e ndryshëm se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk ka deklaruar vlerën e kontratës së shitblerjes së automjetit tip “Mercedes Benz” dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

¹⁹ Deklarim i subjektit në përgjigje të pyetësorit të dytë të drejtuar nga Komisioni.

36. Në analizë të pretendimit të subjektit se veprimi i shkëmbimit të mjeteve pa paguar vlerë monetare shtesë, i përgjigjet së vërtetës, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim, ka arsyetuar: “Nëse krahasojmë vlerën e blerjes së automjetit tip “Mercedes Benz” në shumën 500.000 lekë dhe vlerën e blerjes së automjetit tip “Volkswagen Passat” në shumën 7.000 euro dhe detyrime doganore në shumën 200.313 lekë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shkëmbyer një automjet me vlerë 2-fish më të lartë se vlera e automjetit të tij. Duke marrë në konsideratë faktin se z. A. H. është tregtar automjetesh nga ky shkëmbim lindin dyshime të arsyeshme të një veprimi financiar të pajustificuar dhe të pambështetur në parimet e ekonomisë së tregut (parimi i fitimit), përderisa shitësi shet me një çmim më të ulët mallin”.
Më tej, në vendim, Komisioni arrin në konkluzionin se shkëmbimi i automjeteve i kryer nga subjekti i rivlerësimit përbën një veprim financiar të pajustificuar dhe të pambështetur në parimet e ekonomisë së tregut (parimi i fitimit), përderisa shitësi shet me një çmim më të ulët mallin e sapoblerë.
Trupi gjykues çmon se konkluzioni i mësipërm i Komisionit, i bazuar në faktet e rezultuara nga aktet e mbledhura nga hetimi administrativ, mbetet në nivelin e konstatimit, pasi Komisioni nuk ka shpjeguar se cila është pasoja apo ndikimi që ky veprim ka pasur në procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë dhe cila është përgjegjësia disiplinore e subjektit në këndvështrim të parashikimeve të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se ky konkluzion i Komisionit dhe, për rrjedhojë, edhe pretendimi i subjektit për të nuk përbëjnë relevancë në drejtim të kontrollit të vlerësimit të kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.
37. Konkluzionin e Komisionit se ai dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë burimesh financiare në vlerën 710.891 lekë, për të përballuar blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz” sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.09.2009, subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar me pretendimin se është i pasaktë dhe nuk mbështetet në ligj, në analizën financiare dhe në prova, duke parashtruar argumentet si më poshtë.
Subjekti ka argumentuar se në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2009, shpenzimet e jetesës nuk janë përllogaritur saktë në vlerën 830.000 lekë. Trupi gjykues mori në shqyrtim këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit dhe i krahasoi shpenzimet e jetesës së përllogaritura nga Komisioni, me të dhënat e publikuara nga INSTAT për konsum ushqimor për frymë dhe familjar, të cilat janë përdorur në vite nga ILDKPKI-ja gjatë ushtrimit të kontrollit nga ky institucion, duke iu referuar gjithashtu përbërjes familjare të subjektit të rivlerësimit përgjatë vitit 2009²⁰. Duke përdorur këtë standard përllogaritjeje të shpenzimeve të jetesës, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i drejtë, pasi shpenzimet e jetesës për familjen e tij për vitin 2009, duhet të ishin përllogaritur nga Komisioni në vlerën 430.427 lekë, vlerë e cila do të konsiderohet në analizën financiare në vijim.
Subjekti ka argumentuar gjithashtu se ka gabime në llogaritjen e të ardhurave në vite nga puna e bashkëshortes së tij, pasi ato duhet të ishin përllogaritur në vlerën 733.185 lekë dhe jo 723.185 lekë sa i ka llogaritur Komisioni.
Trupi gjykues, pasi verifikoi dokumentacionin e administruar në fashikull, konstaton se vërtetimi i lëshuar nga qendra e punës së bashkëshortes së subjektit²¹ shoqërohet me pasqyrën analitike për pagesat mujore në lidhje me pagat bruto, ndalesat nga paga, pagat neto dhe kalimet në banka. Nga verifikimi i të dhënave të kësaj pasqyre, trupi gjykues konstaton se nëpërmjet bankës në llogarinë e pagës së bashkëshortes së subjektit ka kaluar vlera 660.056 lekë si diferencë e pagës neto vjetore 709.985 lekë me vlerën e ndalesave për pagesën vjetore të telefonit 49.929 lekë. Nëpërmjet bankës ka kaluar gjithashtu edhe shpërblymi për festat e fundvitit në vlerën 10.000 lekë, për rrjedhojë shuma e të ardhurave të kaluara nëpërmjet bankës është në 670.056 lekë. Komisioni, në analizë, ka marrë në konsideratë vlerën 723.185 lekë si shumë totale të pagës neto vjetore në vlerën 709.985 lekë dhe dietave të shërbimeve

²⁰ Familja e subjektit të rivlerësimit deri në datën 3.12.2009 përbëhej nga tre persona dhe pas datës 3.12.2009 përbëhej nga pesë persona.

²¹ Vërtetimi nr. {***}, datë 26.01.2017, i Avokaturës së Shtetit.

brenda vendit të kryera nga bashkëshortja e subjektit në vlerën 13.200 lekë, duke përjashtuar shpërblimin e fundvitit. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni nuk duhet të kishte përlllogaritur si të ardhur vlerën e dietave të shërbimeve brenda vendit të kryera nga bashkëshortja e subjektit, pasi dietat janë kompensim për një shpenzim të kryer më parë, por duhet të kishte konsideruar vlerën 670.056 lekë e kaluar me bankë në favor të bashkëshortes së subjektit, e cila përfshin pagën neto dhe shpërblimin e fundvitit, i cili nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni. Gjithashtu, Komisioni duhet të kishte zbritur nga të ardhurat edhe pagesën e shërbimit telefonit në vlerën 49.929 lekë, e cila është mbajtur nga pagat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se Komisioni ka përlllogaritur më pak të ardhura sesa do të duhej të llogariste, nuk qëndron.

Trupi gjykues, pasi vlerësoi burimet e ligjshme të subjektit të rivlerësimit për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz” deri në datën 22.09.2009, datë e lidhjes së kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie, duke reflektuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit në lidhje me shpenzimet e jetesës, si dhe vlerën e të ardhurave të bashkëshortes së subjektit sipas shumave të kaluara në favor të saj në llogarinë bankare të pagës, arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht korrektimit të rezultatit negativ të konkluduar prej Komisionit, mbetet me një balancë negative në përfundim të analizës financiare të kryer në Kolegj, në shumën 357.905 lekë, duke konfirmuar konkluzionin e Komisionit se ai ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie.

38. Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

a) subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk ka deklaruar vlerën e kontratës së shitblerjes së automjetit tip “Mercedes Benz” dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;

b) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e pasurisë automjet tip “Mercedes Benz”, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

39. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit i dhënies së shumës 50.000 euro shoqërisë “{***}” ShPK, nuk ka pasur si qëllim fshehjen e këtij veprimi, pasi subjekti i rivlerësimit ka deklaruar marrjen e kredisë në këtë shumë dhe marrëveshjen e lidhur me shoqërinë e ka depozituar në ILDKPKI, si dhe ka pasur burime të mjaftueshme për të përballuar plotësisht këtë veprim financiar, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim²², ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:

(i) ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk ka deklaruar dhënien e shumës 50.000 euro shoqërisë “{***}” ShPK në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit;

(ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për dhënien e shumës 50.000 euro, shoqërisë “{***}” ShPK.

Nga verifikimi i deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se subjekti, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ka deklaruar: *Kredi bankare konsumatore nr. {***} me afat 25 vjet, në vlerën 50.000 euro (bashkëkredimarrës me bashkëshorten). Afati i kredisë: 20.07.2007 deri më 20.07.2022. Kreditues Tirana Bank ShA, dega Shkodër. Shuma e mbetur e pashlyer 25.062 euro.*

Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur kësaj deklarate, ka dorëzuar në ILDKPKI dokumentacionin si vijon.

a) Kontratë kredie bankare konsumatore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.07.2007, e lidhur ndërmjet Tirana Bank, në cilësinë e kredidhënësit, dhe z. Arben Zefi e znj. I. S., në cilësinë e kredimarrësit. Sipas kësaj kontrate, banka jep një kredi në shumën 50.000 euro që

²² Shih faqen 12 të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit.

do të përdoret nga kredimarrësi për nevoja personale, me një kohëzgjatje prej 15 vitesh, duke filluar nga data e disbursimit të kredisë.

b) Aktmarrëveshje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2010, e lidhur ndërmjet z. Arben Zefi dhe administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, z. F. N..

Sipas përmbajtjes së aktmarrëveshjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2010, palët deklarojnë se z. F. N., më datë 20.08.2007, i ka marrë z. Arben Zefi shumën 50.000 euro paradhënie, për vazhdimin e punimeve të një pallati në Shkodër, shumë të cilën do t’ia kthejë në formën e pasurisë së paluajtshme e konkretisht me një sipërfaqe ndërtimi (banimi dhe shërbimi), duke llogaritur çmimin sipas kostos së ndërtimit. Shoqëria “{***}” ShPK merr përsipër të plotësojë detyrimin kundrejt z. Arben Zefi, me mbarimin e plotë të punimeve dhe regjistrimin e pasurisë, pa u kondicionuar në kohë se kur përfundojnë këto punime, kusht ky i pranuar edhe nga z. Arben Zefi. Palët deklarojnë, gjithashtu, se marrëveshja fillimisht është lidhur gojarisht dhe në mirëbesim të plotë, që më datë 20.08.2007, kur është bërë dorëzimi i shumës, por përpilohet me shkrim në datën e nënshkrimit të aktmarrëveshjes, me kërkesë të z. Arben Zefi.

40. Në ankim, subjekti ka parashtruar se mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit i dhënies së shumës 50.000 euro shoqërisë “{***}” ShPK nuk ka pasur si qëllim fshehjen e këtij veprimi, pasi ai ka deklaruar marrjen e kredisë në këtë shumë dhe marrëveshjen e lidhur me shoqërinë e ka depozituar në ILDKPKI.
41. Në analizë të këtij pretendimi në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, trupi gjykues vëren se Komisioni nuk e ka ngarkuar subjektin me përgjegjësi për fshehje pasurie, por për deklarim të pasaktë. Në kushtet kur, ashtu siç ka deklaruar dhe vetë subjekti gjatë hetimit administrativ, aktmarrëveshja e lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK nuk është konkretizuar akoma, pra palët janë në të njëjtat kushte si në datën e nënshkrimit të saj, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, kishte detyrimin të deklaronte lidhjen e aktmarrëveshjes me shoqërinë “{***}” ShPK, së cilës i kishte paguar paradhënie shumën 50.000 euro, që do t’i kthehej nga kjo shoqëri në formën e pasurisë së paluajtshme e konkretisht të një sipërfaqeje ndërtimi (banimi dhe shërbimi). Ky detyrim i subjektit buron nga parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, neneve 30-32 dhe kërkesave të shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016 – deklaratës së pasurisë së rivlerësimit. Aktet e sipërcituara tërheqin vëmendjen e subjektit për një kujdes të shtuar në plotësimin e deklaratës, pasi çdo pakujdesi passjell përgjegjësinë disiplinore të tij. Për më tepër që subjekti i rivlerësimit, ashtu siç edhe vetë ka pranuar gjatë hetimit administrativ në Komision, është hetuar nga ILDKPKI-ja në kontrolle të mëparshme të pasurisë dhe mosdeklarimi prej tij i dhënies së shumës prej 50.000 eurosh shoqërisë “{***}” ShPK, është identifikuar nga ILDKPKI-ja si pasaktësi në deklarim²³, duke i krijuar kështu subjektit qartësinë e detyrimit të deklarimit të dhënies së kësaj shume sipas aktmarrëveshjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.20, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.
42. Në analizë të pretendimit të subjektit se ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar dhënien e shumës 50.000 euro shoqërisë “{***}” ShPK, trupi gjykues konstaton se në aktmarrëveshjen nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2010, administratori i shoqërisë “{***}” ShPK ka deklaruar se më datë 20.08.2007, ka marrë nga z. Arben Zefi shumën prej 50.000 eurosh si paradhënie, ndërsa z. Arben Zefi ka deklaruar se shumën 50.000 euro e ka marrë në formën e kredisë pranë Tirana Bank, dega Shkodër, me destinacion lidhjen e kësaj marrëveshjeje. Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se shuma prej 50.000 eurosh nuk është paguar në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, nëpërmjet sistemit bankar. Nga verifikimi i lëvizjeve në llogarinë bankare të subjektit

²³ Lidhja e kësaj aktmarrëveshjeje nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe as në deklaratat periodike të pasurisë në vitin 2010 e vitin 2007.

në Tirana Bank²⁴, rezulton se në datën 25.07.2007, në llogarinë në euro nr. {***}, në emër të z. Arben Zefi, është kredituar shuma 50.000 euro, ndërsa në datën 27.07.2007, z. Arben Zefi ka tërhequr shumën 45.000 euro, duke mbetur pjesa tjetër e kredisë gjendje në llogarinë bankare edhe pas datës 20.08.2007, datë e deklaruar nga palët si data kur shoqëria "{***}" ShPK ka marrë shumën 50.000 euro si paradhënie.

Nga analiza financiare, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit e ka pasur të pamundur që në datë 20.08.2007, t'i jepte shoqërisë "{***}" ShPK vlerën prej 50.000 eurosh, pasi ka pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare për të kryer këtë veprim, në vlerën 172.950 lekë.

43. Në vijim të analizës së mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk ka deklaruar pagimin e shumës 50.000 euro si paradhënie për përfitimin e një sipërfaqeje ndërtimi (banimi dhe shërbimi) të shoqëria "{***}" ShPK në vitin 2007, në kundërshtim me nenin 33, pika 5, shkronja "a" e ligjit nr. 84/2016 dhe se subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për dhënien e shumës 50.000 euro shoqërisë "{***}" ShPK, në vlerën 164.971 lekë, në përputhje me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016. ***Për sa më sipër, vlerësimi i Komisionit është i drejtë, ndërsa pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.***
44. *Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit se ai ka qenë në situatën e konfliktit të interesit, sepse ka shqyrtuar një padi të shoqërisë "{***}" ShPK, duke qenë ende në marrëdhënie interesi me të, është një konkluzion joligjor, pasi në çdo rast ai ka zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, të cilat prevalojnë mbi ato të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim²⁵, ka arritur në konkluzionin se: Subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e konfliktit të interesit, pasi ka shqyrtuar një padi të shoqërisë "{***}" ShPK, duke qenë ende në marrëdhënie interesi me të.*
45. Nga shqyrtimi i akteve të hetimit administrativ të Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti, në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendim nr. {***}, datë 11.04.2015, ka vendosur pranimin e padisë së shoqërisë "{***}" ShPK, me objekt: "Pavlefshmëri e titullit ekzekutiv, faturë energjie".
46. Në ankim, subjekti ka pretenduar se në çështjen gjyqësore për të cilën ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 11.04.2015, në konflikt gjyqësor kanë qenë subjektet private "{***}" ShPK dhe {***} ShA, me të cilat ai kishte marrëdhënie kontraktuale. Në seancë gjyqësore, pasi iu është bërë prezent situata, palët kanë qenë dakord me trupin gjykues dhe nuk kanë paraqitur as më të voglin dyshim apo kundërshti me trupin gjykues. Edhe në ankimin e ushtruar në gjykatën e apelit nuk është ngritur një pretendim i tillë dhe kjo gjykatë e ka lënë në fuqi vendimin. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nëse Komisioni vlerëson se ka shkaqe përjashtueshmërie të trupit gjykues, atëherë çështja duhet t'i referohet Këshillit të Lartë Gjyqësor, në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, pasi në rastin konkret prevalojnë dispozitat e Kodit të Procedurës Civile kundrejt dispozitave të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.
47. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me legjislacionin e zbatueshëm në rastin konkret, trupi gjykues vlerëson se dispozitat e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike"

²⁴ Ky informacion është përcjellë në Komision nga Banka e Tiranës me shkresën nr. {***} prot., datë 15.02.2018 dhe me shkresën nr. {***} prot., datë 17.04.2018.

²⁵ Shih faqen 34 të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit.

(në vijim “ligji nr. 9367/2005”) janë komplementare me ato të Kodit të Procedurës Civile për rastet e përjashtimit të gjyqtarit.

Ligji nr. 9367/2005 në nenin 4, pika 1, shkronja “a”, nënndarja “ii” ka përcaktuar detyrimin për zbatimin e dispozitave të tij, edhe për çdo zyrtar, kur ai merr pjesë në një vendimmarrje për akte të organeve gjyqësore, ndërsa në nenin 13, pika 2 parashikon: *2. Për proceset gjyqësore dhe hetimet parlamentare, identifikimi dhe regjistrimi i interesave, sipas këtij kreu, bëhen vetëm për ato veprime që kryhen para dhe jashtë një procesi konkret gjyqësor civil, një procedimi penal ose hetimi parlamentar. Brenda këtij procesi, identifikimi dhe regjistrimi i interesave kryhen sipas rregullave të përcaktuara, sipas rastit, në kodet e procedurave civile dhe penale, si dhe të legjislacionit që rregullon procesin e hetimit parlamentar.*

Kjo dispozitë, në kundërshtim me sa pretendon subjekti i rivlerësimit, nuk përjashton veprimtarinë e gjyqtarëve nga fusha e zbatimit të ligjit nr. 9367/2005 për sa i përket detyrimin të tyre për të verifikuar dhe shmangur konfliktin e vazhdueshëm dhe rast pas rasti të interesit, por identifikimi dhe regjistrimi i interesave në këtë rast do të jetë sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile. Pika 6 e nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile parashikon si rast të përjashtimit të gjyqtarit, përveç rasteve të përcaktuara shprehimisht në pikat e tjera të këtij neni, edhe çdo rast tjetër kur vërtetohen sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie. Ky parashikim është pika prerëse mes përcaktimeve të ligjit nr. 9367/2005 dhe përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile. Përkufizimi i interesave privatë, i parashikuar në nenin 5 të ligjit nr. 9367/2005, i shërben gjyqtarit për të vlerësuar rast pas rasti nëse është apo jo në kushtet e arsyeve serioze të njëanshmërisë, të tilla që të cenojnë procesin e rregullt ligjor, por në çdo rast procedura për trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit do të jetë ajo e parashikuar në Kodin e Procedurës Civile. Për këtë arsye, ligji nr. 9367/2005, në nenin 40, pika 3 ka parashikuar se: *3. Aktet e përcaktuara në shkronjën “a”, “ii” të pikës 1 të nenit 4 të këtij ligji, të nxjerra në praninë e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, rishihen dhe rrëzohen për këtë shkak nga organi përkatës, në përputhje me kompetencat e tij për të vendosur në lidhje me këtë çështje, sipas përcaktimeve dhe sipas rastit, në Kodin e Procedurës Civile ose në Kodin e Procedurës Penale apo në ligje të tjera, që rregullojnë regjimin e këtyre akteve.*

Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit ka pasur një marrëdhënie interesi me shoqërinë “{***}” ShPK, e pranuar dhe e provuar nga vetë ai me aktmarrëveshjen nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.04.2010, e lidhur ndërmjet tij dhe administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, z. F. N.. Sipas përmbajtjes së kësaj aktmarrëveshjeje, palët deklarojnë se z. F. N. më datë 20.08.2007 i ka marrë z. Arben Zefi shumë 50.000 euro paradhënie për vazhdimin e punimeve të një pallati në Shkodër, shumë të cilën do t’ia kthejë në formën e pasurisë së paluajtshme e konkretisht me një sipërfaqe ndërtimi (banimi dhe shërbimi), duke llogaritur çmimin sipas kostos së ndërtimit. Sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, marrëdhënia e tij e interesit me shoqërinë “{***}” ShPK nuk kishte përfunduar ende²⁶. Në kuptim të nenit 5, pika 1 e ligjit nr. 9367/2005 apo të nenit 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, kjo marrëdhënie juridike civile me karakter pasuror, përbën interes privat të zyrtarit/gjyqtarit. Trupi gjykues çmon se, meqenëse rezultoi e provuar ekzistenca e interesave privatë në kuptim të ligjit nr. 9367/2005, atëherë shtrohet për diskutim ekzistenca e konfliktit të interesit në rastin konkret, për sa kohë që konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike. Duke pasur parasysh marrëdhënien e drejtpërdrejtë juridiko-civile me karakter pasuror, mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, e trajtuar në

²⁶ Në përgjigje të pyetësorit të dytë të Komisionit, subjekti ka deklaruar: “Marrëveshja nuk është finalizuar, pasi nuk kemi rënë dakord akoma. Kam premtimin e shoqërisë që në rast se nuk biem dakord për sasinë e sipërfaqes apo llojin e pasurisë së paluajtshme, shoqëria “{***}” ShPK do të më paguajë të gjithë kredinë dhe interesat bankarë, në momentin që më mbaron afati i kredisë të Tirana Bank”.

raport me përcaktimet e ligjit nr. 9367/2005, trupi gjykues arrin në përfundimin se në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit në këtë vendimmarrje gjyqësore, pasi marrëdhënia kontraktore mes subjektit dhe palës ndërgjyqëse, shoqërisë “{***}” ShPK, ende nuk kishte përfunduar.

Në këto kushte e gjejmë të drejtë konkluzionin e Komisionit, në vendim²⁷, se *subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të kishte dhënë dorëheqjen nga gjykimi i kësaj çështjeje gjyqësore, duke u vetëpërgjyqësuar paraprakisht nga procesi konkret vendimmarrës, pasi ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit.*

48. Edhe pretendimin e subjektit se ai e ka zgjidhur rastin në fjalë, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, duke pyetur palët në seancë gjyqësore pasi iu është bërë prezent situata dhe palët kanë qenë dakord me trupin gjykues duke mos paraqitur kundërshti, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar në parashikimin e nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas këtij neni, *gjyqtari, i cili vlerëson me ndërgjegje se ka shkaqe të arsyeshme për të mos marrë pjesë në shqyrtimin e një çështjeje, i kërkon kryetarit të gjykatës zëvendësimin e tij. Kryetari i gjykatës, kur e sheh me vend kërkesën, urdhëron zëvendësimin e tij me një gjyqtar tjetër, me anë të shortit.*

Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit nuk ka ndjekur procedurën e kërkuar nga ligji, e cila parashikon paraqitjen e kërkesës për heqje dorë te kryetari i gjykatës, i cili bën vlerësimin në lidhje me arsyet e ekzistencës ose jo të njëanshmërisë.

Pretendimi i subjektit se nëse Komisioni vlerëson se ka shkaqe përjashtueshmërie të trupit gjykues, atëherë çështja duhet t’i referohet Këshillit të Lartë Gjyqësor, në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, vlerësohet nga trupi gjykues si i pabazuar, pasi subjekti nuk ndodhet në kushtet e nenit të sipërcituar, i cili parashikon transferimin e çështjes pranë organit kompetent për inspektimin, vetëm në rastet, kur Komisioni ka dhënë një vendim konfirmimi për subjektin e rivlerësimit.

49. Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka qenë në situatën e konfliktit të interesit, pasi ka shqyrtuar një padi të shoqërisë “{***}” ShPK, duke qenë ende në marrëdhënie interesi me të.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

50. *Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se likuiditetet në banka rrjedhin nga paga e tij si gjyqtar dhe përbëjnë një pasuri të ligjshme të tij, prandaj konkluzioni i Komisionit se ai ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, sepse nuk ka deklaruar këto likuiditete, nuk është i drejtë, trupi gjykues vëren se Komisioni në vendim²⁸, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:*

(i) ka bërë deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit, shumën 300.000 lekë, në formën e depozitës pranë Tirana Bank;

(ii) ka bërë deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit gjendjen në llogarinë në lekë pranë Tirana Bank.

51. Në shqyrtim të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues, nga verifikimi i llogarive bankare të tij në Tirana Bank, përcjellë nga kjo e fundit në Komision me shkresat nr. {***} prot., datë 15.02.2018 dhe nr. {***} prot., datë 17.04.2018, konstaton se në datë 27.05.2005, subjekti i rivlerësimit ka krijuar depozitë me afat në shumën 500.000 lekë për sigurim karte Visa. Në datën 22.06.2007 ka zvogëluar depozitën në shumën 200.000 lekë duke mbetur shuma prej 300.000 lekësh, e cila ka vazhduar si gjendje deri në fund të vitit 2016. Kjo depozitë në shumën 300.000 lekë nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit nga ana e subjektit të rivlerësimit.

²⁷ Shih faqen 30 të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit.

²⁸ Shih faqen 28 të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit.

52. Në ankim, subjekti ka pretenduar se llogaria e ngurtësuar 300.000 lekë është formuar nga banka për të garantuar shërbimet e veta dhe është krijuar nga kalime nga llogaria e tij e pagës, nga fonde të akumuluar nga pagat, pra janë kalime nga llogaria e pagës në llogarinë e depozitës dhe nuk passjellin asnjë produkt financiar që sjell të ardhura.
53. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues vlerëson se është e vërtetë që depozita në shumën 500.000 lekë, e reduktuar më pas në shumën 300.000 lekë, është një depozitë e lidhur drejtpërdrejt me kartën e kreditit *Visa* të subjektit të rivlerësimit, por këto veprime financiare nuk janë kryer nga banka pa dijeninë e tij, por përkundrazi, në përputhje me kontratën përkatëse të pajisjes me kartën e kreditit. Pretendimi i subjektit në ankim se këto janë kalime brenda së njëjtës bankë dhe nuk passjellin asnjë produkt financiar që sjell të ardhura, vjen në kundërshtim me deklarinimin e tij gjatë hetimit administrativ në Komision se ka përfituar interesa nga balanca e kësaj depozite në vlerën totale 123.831 lekë me një mesatare vjetore prej 9.525 lekësh në vit. Trupi gjykues vlerëson se ngrirja e shumës monetare si garanci për shkak të pajisjes me kartë *Visa*, në vetvete shërben si kursim për subjektin, pasi në momentin e mbylljes së llogarisë së kartës *Visa*, kjo shumë nëse është ende gjendje, i kthehet atij. Në këto kushte, subjekti kishte detyrimin, të deklaronte në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit shumën e depozitës si garanci të kësaj karte dhe gjendjen e llogarisë së kartës *Visa*, në datën 31.12.2016. Për këtë arsye, trupi gjykues e çmon të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, për shkak të mosdeklarimit të depozitës bankare në shumën 300.000 lekë.
54. Në analizë të pretendimit të subjektit në ankim, se bazuar në vendimin nr. 11, datë 22.11.2018, të Kolegjit, mosdeklarimi i gjendjes së llogarisë së pagës në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, nuk përbën fshehje pasurie, trupi gjykues konstaton se nga verifikimi i llogarive bankare pranë Tirana Bank, konstatohet se në llogarinë e pagës së subjektit të rivlerësimit, më datë 31.12.2016, gjendja është në vlerën 598.607 lekë, e cila nuk rezulton e deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Gjendjet në fund të vitit të kësaj llogarie²⁹, nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave private. Trupi gjykues vlerëson se me mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit të gjendjes së llogarisë bankare më datë 31 dhjetor 2016, si një detyrim i parashikuar nga Aneksi D i Kushtetutës dhe nenet, 3, pika 11, 30-32 e shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues, çmon të qartësojë se qëndrimi i Kolegjit në vendimi nr. 11, datë 22.11.2018, në ndryshim nga sa pretendon subjekti, lidhet me deklarinimet e gjendjeve të llogarive të pagave në deklarinimet periodike të interesave nga zyrtari deklarues/subjekti i rivlerësimit. Në rastin konkret, mosdeklarimi i gjendjes së llogarisë bankare të pagës nga subjekti i rivlerësimit është kryer në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, për pasojë trupi gjykues vlerëson se situatat nuk janë të ngjashme, që të gjejë vend zbatimi i jurisprudencës së Kolegjit.
55. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, për shkak të mosdeklarimit të depozitës bankare dhe gjendjes së llogarisë bankare të pagës, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
- Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.***

²⁹ Gjendjet në llogarinë e pagës nr. {***} në Tirana Bank, më datë 31 dhjetor të çdo viti janë: në vitin 2005: 560.543 lekë; në vitin 2006: 123.122 lekë; në vitin 2007: 266.054 lekë; në vitin 2008: 56.086 lekë; në vitin 2009: 234.606 lekë; në vitin 2010: 441.413 lekë; në vitin 2011: 64.445 lekë; në vitin 2012: 157.815 lekë; në vitin 2013: 304.787 lekë; në vitin 2014: 928.578 lekë; në vitin 2015: 776.654 lekë.

56. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se mosdeklarimi në deklaratën e rivlerësimit i marrjes së shumës 100.000 dollarë amerikanë nga z. R. D. nuk ka qenë i qëllimshëm, por duke qenë se ky transaksion bankar nuk ka sjellë shtim apo pakësim të pasurisë, ai e ka menduar si të panevojshëm deklarin. Llogaria e subjektit është përdorur vetëm për transfertën bankare dhe ai nuk ka pasur asnjë përfitim. Ky veprim nuk ka cenuar ligjin, moralin shoqëror, etikën e gjyqtarit dhe nuk ka sjellë asnjë impakt te të tretët.*
Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim³⁰, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk ka deklaruar marrjen e shumës 100.000 dollarë amerikanë (në vijim “USD”) nga z. R. D. në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, si dhe ka dhënë deklarin të pamjaftueshëm në lidhje me këtë shumë.
57. Në lidhje me këtë konkluzion të Komisionit, subjekti, në ankim, ka pretenduar se kalimi i shumës 100.000 USD nuk është paraqitur prej tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, sepse kjo shumë vërtet ka kaluar nëpërmjet llogarisë së tij bankare, por në fakt përfitues i shumës ka qenë z. R. D., shtetas kanadez, i cili në atë periudhë kishte ardhur në Shqipëri dhe kërkonte të tërhiqte nga llogaria e tij në Kanada një sasi parash. Ai nuk kishte mundësi të hapte një llogari bankare në Shqipëri për shkak të procedurave bankare, pasi ishte shtetas kanadez. Sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit, ditën e kalimit dhe tërheqjes së parave z. R. D. ka qenë i pranishëm në bankë dhe ka marrë paratë. Subjekti pretendon se nuk e ka deklaruar këtë shumë parash në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi ajo nuk ka sjellë as shtim dhe as pakësim të pasurisë së tij.
58. Në analizë të pretendimeve të subjektit, nga shqyrtimi i akteve të hetimit administrativ të Komisionit, trupi gjykues konstaton situatën faktike si vijon.
Nga verifikimi i llogarisë nr. {***} në USD, në Tirana Bank, në emër të z. Arben Zefi, rezulton se më datë 13.08.2007 ka kaluar shuma 100.000 USD, me përshkrimin: *Kalim shume R. D. për t’u përdorur për pagesë blerje apartamenti për llogari të z. R. D. tek {***}*. Shuma e mësipërme është tërhequr *cash* nga subjekti i rivlerësimit më datë 13.08.2007 në vlerën 50.000 USD, me përshkrimin: *Tërheqje nga Arben Zefi për të bërë pagesë kësti për blerje apartamenti për llogari të z. R. D.*, si dhe më datë 15.08.2007, në vlerën 50.000 USD, me përshkrimin: *Tërheqje nga Arben Zefi, Shkodër*.
Shuma prej 100.000 USD nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe as në deklaratën periodike të interesave private të vitit 2007.
Bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, për të provuar se nuk ka qenë ai përfituesi i shumës prej 100.000 USD, ka paraqitur dy deklarata të z. R. D., një në gjuhën shqipe dhe një në gjuhën angleze.
Në deklaratën e hartuar në gjuhën shqipe, z. R. D. deklaron se është shtetas shqiptar dhe kanadez, me banim në {***}, Kanada. Gjithashtu, ai deklaron se: *Shuma prej 100.000 USD e transferuar në llogarinë e z. Arben Zefi është bërë për qëllim të blerjes së një prone nga ana ime në Shqipëri dhe është transferuar përsëri në llogarinë time, pasi nuk u realizua blerja nga ana ime dhe z. Arben Zefi nuk ka përfituar asnjë vlerë monetare nga kjo transfertë. Gjatë periudhës që është bërë kjo transfertë, unë kam qenë personalisht në Shqipëri, në proces të hapjes së një fabrike riciklimi të plastikës [...]. Kjo fabrikë është financuar 100% nga unë dhe transfertat e vlerave monetare është bërë në rrugë bankare nga TD Bank në Kanada te Raiffeissen Bank Albania.*
Në deklaratën e hartuar në gjuhën angleze, z. R. D. deklaron se: *Për të transferuar këtë shumë kam përdorur e-banking, sepse në atë kohë kam qenë në Shqipëri. Llogaria e z. Arben Zefi është përdorur vetëm për të kaluar këtë shumë, pasi unë nuk kisha një llogari bankare në Shqipëri. Ishte e pamundur për mua të hapja një llogari bankare, sepse isha shtetas kanadez dhe jo rezident në Shqipëri [...]. Paratë që transferova me bankë, i tërhoqa më pas dhe i*

³⁰ Shih paragrafin “vii” në faqen 28 të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit.

mora cash nga Tirana Bank. Nëse banka ka regjistrimet video, do të shihej se kam qenë prezent në bankë në datat 13 dhe 15 gusht 2007.

Subjekti, bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka paraqitur dhe një deklaratë të znj. N. D., bashkëshortes së z. R. D., e cila deklaron: *Jam në dijeni të plotë se bashkëshorti im R.D. ka dërguar në Shqipëri, në Bankën Tirana, më 13 dhe 15 gusht 2007, shumën prej 100.000 USD me mendimin për të blerë pasuri të paluajtshme dhe e ka kaluar në llogarinë e Arben Zefi, burri i vajzës së tezes sime. Kjo shumë është transferuar në Shqipëri për llogari të bashkëshortit tim dhe Arben Zefi nuk ka përfituar asgjë.*

59. Në analizë të pretendimeve të subjektit, në raport me situatën faktike të përshkruar më sipër, trupi gjykues vlerëson se deklaratat e hartuar në gjuhën angleze e z. R. D. nuk përmban elementet e nevojshme të një shkrese për të fituar vlerë provuese dhe as elementet e një shkrese të thjeshtë, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, neneve 246 dhe 258 të tij³¹, pasi në të mungon nënshkrimi i personit deklarues, duke mos arritur kështu t'i krijojë trupit gjykues sigurinë se deklaratimet janë të personit deklarues. Por, edhe deklaratat e hartuar në gjuhën shqipe, e cila është nënshkruar nga z. R. D., referuar jurisprudencës së Kolegjit, nuk mund të ketë vlerë provuese në gjykimin në Kolegj, pasi nuk është hartuar para noterit publik, në mënyrë që të garantojë shfaqjen e pavesuar të vullnetit të personit deklarues.

Por trupi gjykues çmon të theksojë se edhe nëse deklaratat e z. D. do të konsiderohej me vlerë të plotë provuese në aspektin formal, përmbajtja e saj nuk arrin të provojë arsyen e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit për përdorimin e llogarisë së tij bankare për t'i mundësuar z. R. D. transferimin e parave, në kushtet kur ai nuk mund të hapte një llogari bankare se ishte shtetas kanadez, pasi vetë z. R. D. ka pranuar se ka edhe shtetësi shqiptare dhe në të njëjtën periudhë ka transferuar nga Kanadaja në Shqipëri, nëpërmjet llogarive të tij bankare, shuma të konsiderueshme parash për hapjen e një biznesi në Shqipëri. Z. D. ka deklaruar gjithashtu se shuma prej 100.000 USD është transferuar përsëri në llogarinë e tij, pasi nuk u realizua blerja e pronës së dëshiruar prej tij, por nuk ka paraqitur asnjë akt provues për të vërtetuar deklaratimet e tij.

Të njëjtin qëndrim, trupi gjykues mban edhe në lidhje me deklaratën e znj. N. R., e cila nuk mund të ketë vlerë provuese në gjykimin në Kolegj, pasi znj. N. R. nuk e ka hartuar deklaratën e saj para noterit publik. Por, edhe nëse deklaratat e saj do të konsiderohej me vlerë të plotë provuese, faktet e deklaruara prej saj vijnë në kundërshtim me ato të provuara gjatë hetimit administrativ, pasi znj. D. deklaron se bashkëshorti i saj, z. R. D., ka dërguar në Shqipëri, nëpërmjet Tirana Bank, më 13 dhe 15 gusht 2007, shumën prej 100.000 USD, ndërsa nga hetimi administrativ ka rezultuar se kjo shumë është transferuar si e tërë, vetëm në një datë, më datë 13.08.2007, dhe më pas është tërhequr në datat 13 dhe 15 gusht 2007 nga z. Arben Zefi. Trupi gjykues vlerëson se mbetet i paprovuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk ka qenë ai përfituesi i shumës prej 100.000 USD, kaluar në llogarinë e tij bankare në Tirana Bank, nga z. R. D..

60. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, gjithashtu, se Komisioni ka refuzuar marrjen e dëshmisë së z. R. D., duke shkelur nenin 49, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, në lidhje me pikën 6, 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016. Në shqyrtim të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues konstaton se ai nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë procedurale për thirrjen si dëshmitar të z. R. D., në asnjë fazë të hetimit administrativ në Komision. Gatishmëria e z. R. D., e shprehur në deklaratën e

³¹ Kodi i Procedurës Civile, në nenin 246, “Fuqia provuese e shkresave”, parashikon: “Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishitje, ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen.”, ndërsa në nenin 258, “Shkresa e thjeshtë”, parashikon se: “Shkresa që është përpiluar nga një person zyrtar që nuk ka qenë kompetent ose që nuk është sipas formës së caktuar, ka fuqinë provuese të një shkrese të thjeshtë, në rast se është nënshkruar nga palët”.

tij, për të dëshmuar personalisht në rast nevojë, nuk mund të konsiderohet si një kërkesë procedurale e subjektit për ta thirrur atë si dëshmitar.

61. Trupi gjykues nuk e gjen të bazuar në aktet e hetimit administrativ as pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka shkelur nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar barrën e provës, në një kohë kur vetë Komisioni nuk kishte asnjë provë se këto para ishin marrë nga subjekti i rivlerësimit. Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar marrëdhënien e tij me shumën 100.000 USD, e transferuar në llogarinë e tij bankare dhe e tërhequr prej tij, si dhe për arsyet e mosdeklarimit të kësaj shume në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. Subjekti i janë vënë në dispozicion nga Komisioni, aktet e hetimit administrativ dhe ai ka marrë dijeni për to³², ndër të cilat edhe lëvizjet në llogarinë e tij bankare në Tirana Bank, të përcjella në Komision nga kjo bankë, të cilat provojnë veprimet e kryera nga subjekti në tërheqjen e këtyre shumave nga llogaria e tij bankare. Në këtë kuptim, Komisioni ka zbatuar saktësisht pikën 2 të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës: *Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelimit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.*
62. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte marrëdhënien e tij me shumën prej 100.000 USD, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, e kaluar në llogarinë e tij bankare në datën 13.08.2007 nga një person i tretë dhe e tërhequr prej tij në datë 13.08.2007 dhe 15.08.2007, bazuar në parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 3, pika 11, 30-32 dhe shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.
63. *Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, ai ka pasur burime të ligjshme financiare për të mbuluar shpenzimet e kryera në {***} nga vëllai i tij, në vitet 2006, 2007 dhe 2009, pasi këto shpenzime i janë rimbursuar nga motra e tij, por edhe po të merren të mirëqena, ai ka pasur të ardhura të ligjshme dhe plotësisht të verifikueshme për t'i përballuar këto shpenzime, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim³³, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për të mbuluar shpenzimet e kryera në {***} nga ana e personit të tretë (vëllai i tij) për vitet 2006, 2007 dhe 2009.*
64. Në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, subjekti, në ankim, ka pretenduar se të gjitha paratë e tërhequra nga llogaria e tij dhe të përdorura nga i vëllai janë përballuar nga e motra, e cila banon në Kaliforni, ShBA, por deklaratat e motrës dhe vëllait të tij, lidhur me këtë fakt, nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se Komisioni ka refuzuar marrjen e dëshmisë së motrës së tij, znj. Z. W., dhe vëllait të tij, z. A. Z., duke shkelur nenin 49, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, në lidhje me pikën 6, 2 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016.
65. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, në raport me aktet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se nga informacioni i përcjellë në Komision nga Tirana Bank, rezulton se nga llogaria e pagës së subjektit të rivlerësimit me nr. {***} dhe nga llogaria rrjedhëse në euro me nr. {***}, gjatë vitit 2006, 2007 dhe 2009, janë tërhequr shuma nga bankomate në {***}, Itali.

³² Subjekti ka nënshkruar aktet “Deklaratë”, në datat 12 dhe 13 dhjetor 2018, në të cilat ka pranuar marrjen e të gjithë dokumentacionit të dosjes së hetimit administrativ në Komision.

³³ Shih faqen 28 të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit.

Gjatë hetimit administrativ në Komision³⁴, subjekti ka deklaruar se karta e llogarisë së tij bankare është përdorur nga vëllai i tij në vitet 2006, 2007 dhe 2009, kur ndiqte studimet e larta në Universitetin e {***}, në Itali. Gjithashtu, ai ka shpjeguar se të gjitha paratë e tërhequra nga llogaria e tij dhe të përdorura nga i vëllai janë përballuar nga e motra, znj. Z. W., e cila banon në Kaliforni, ShBA.

Bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, subjekti, në përgjigje të barrës së provës, ka paraqitur një deklaratë të znj. Z. W., të datës 21.12.2018, në të cilën ajo deklaron: “Kam financuar studimet e A. në Itali, sa herë ka pasur nevojë. I kam kërkuar Arbenit që të lejojë A. të përdorë kartën e tij të debitit dhe kam rimbursuar Arbenin për të gjitha shpenzimet e lidhura me përdorimin e kartës së debitit nga A.. Kur kam vizituar prindërit në Shqipëri dhe kur kam marrë prindërit me pushime në Kaliforni, u kam dhënë fonde që t’i kenë në dispozicion për të rimbursuar Arbenin për harxhimet e përdorimit të kartës së debitit [...]. Arbeni nuk ka shpenzuar asgjë, pasi unë ia kam rimbursuar atij të gjitha shpenzimet në lidhje me përdorimin e kartës së debitit deri në qindarkën e fundit”.

Subjekti ka paraqitur gjithashtu edhe një deklaratë zëvendësuese e aktit noterial, datë 17.12.2018, në të cilën z. A. Z., vëllai i subjektit, deklaron: “Karta e debitit e lëshuar për z. Arben Zefi është përdorur nga ana ime në mënyrë ekskluzive nga janari i vitit 2006 dhe më pas, pa asnjë barrë mbi z. Arben Zefi, meqenëse të gjitha shumat e tërhequra me kartë ishin të mbuluara nga financimi që motra jonë Z. W., nënshtetase amerikane, ka bërë në favorin tim”. Në shqyrtim të dokumentacionit të dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit si më sipër, trupi gjykues konstaton se deklarata e znj. Z. W. dhe deklarata e z. A. Z. nuk janë bërë para noterit publik dhe nuk janë akte të legalizuara. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se këto deklarata, në aspektin formal, nuk garantojnë shprehjen e vullnetit të pavesuar të personave deklarues. Trupi gjykues, në vijim edhe të jurisprudencës së Kolegjit në raste të ngjashme, vlerëson se këto deklarata nuk mund të kenë vlerë provuese në gjykimin në Kolegj.

66. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, edhe nëse deklaratat e të afërmeve të subjektit të rivlerësimit do të konsideroheshin me vlerë të plotë provuese, duke qenë se nuk janë të shoqëruara me asnjë dokumentacion provues të deklarimeve të personave deklarues, ato nuk arrijnë të provojnë se shumat që subjekti i rivlerësimit i ka vënë në dispozicion vëllait të tij nëpërmjet dhënies në përdorim të kartës së debitit, i janë rimbursuar nga motra e tij. Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se në favor të tij nuk është kryer ndonjë transfertë nga motra e tij, znj. Z. W., dhe po kështu subjekti nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë kthimin e shumave të shpenzuara nga vëllai i tij. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka refuzuar marrjen e dëshmisë së të afërmeve të tij, trupi gjykues konstaton se ai nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë procedurale për thirrjen si dëshmitarë të personave të sipërcituar, në asnjë fazë të hetimit administrativ në Komision, në mënyrë që një kërkesë e tillë të shqyrtohej nga Komisioni.

Në këto kushte, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit, i cili i ka konsideruar si shpenzime të kryera nga subjekti i rivlerësimit, shumat e tërhequra nga llogaritë e tij bankare nga vëllai i tij, nëpërmjet përdorimit të kartës së debitit që i përkiste subjektit të rivlerësimit.

67. Trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, gjen të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se konkluzioni që ka bërë deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, në lidhje me përdorimin e të ardhurave të tij, është një konkluzion i nxjerrë jashtë parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në ndryshim nga arsyetimi i përdorur prej Komisionit, trupi gjykues vlerëson se bazuar në kërkesat e neneve 30-32 dhe shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrimin që në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit të deklaronte shpenzimet e kryera në vitet 2006, 2007 dhe 2009.

³⁴ Deklarimet e subjektit të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit të dytë të drejtuar nga Komisioni.

68. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se edhe po të merret e mirëqenë se shpenzimet e kryera nga vëllai gjatë kohës së studimeve në {***} janë përballuar prej tij, ai ka pasur të ardhura të ligjshme dhe plotësisht të verifikueshme për t'i përballuar këto shpenzime, trupi gjykues mori në shqyrtim secilin prej pretendimeve të tij lidhur me zërat e analizës financiare të kryer nga Komisioni për vitet 2006, 2007 dhe 2009.
69. Në analizën financiare të vitit 2006, subjekti ka kundërshtuar vlerën 500.000 lekë të përlllogaritur nga Komisioni si shumë e përdorur për arredimin e apartamentit me sipërfaqe 132,8 m², pasi as ai dhe as bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar shpenzime për arredim në deklaratën periodike të interesave privatë të vitit 2006. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues verifikoi deklaratimet e tij gjatë hetimit administrativ në Komision, nga ku rezulton se pyetjes së Komisionit në lidhje me vlerën e arredimit të apartamentit me sipërfaqe 132,8 m², subjekti i është përgjigjur se kjo vlerë ka qenë afërsisht 1.000.000 lekë. Duke mbajtur në konsideratë se kontrata për shitblerjen e apartamentit me sipërfaqe 132,8 m² është lidhur në datën 27.03.2005, shitja e apartamentit 56,1 m² ku subjekti banonte më parë është kryer në datë 21.07.2005 dhe se subjekti në deklaratimet e tij gjatë hetimit në Komision, por edhe në ankim nuk ka deklaruar se sa ka qenë vlera e saktë e arredimit të kryer në vitin 2006, trupi gjykues vlerëson se është e logjikshme përlllogaritja nga Komisioni e vlerës 500.000 lekë, si gjysma e vlerës totale të arredimit, e kryer gjatë vitit të dytë të banimit të subjektit e familjes së tij në apartamentin me sipërfaqe 132,8 m², prandaj kjo vlerë është mbajtur në konsideratë edhe në analizën financiare të kryer në Kolegj, për vitin 2006. Nga verifikimi i vlerave të tërhequra nga vëllai i subjektit të rivlerësimit në bankomat [ATM] në {***} në Itali, rezulton se në vitin 2006 është tërhequr në total vlera 613.488 lekë dhe jo 316.404 lekë sa ka përlllogaritur Komisioni. Në përlllogaritjen e kësaj vlere në analizën financiare të vitit 2006, rezulton se situata financiare e subjektit thellohet në vlerën negative 428.312 lekë dhe subjekti nuk arrin të justifikojë me burime të ligjshme shpenzimet e kryera për vëllanë e tij në {***}, Itali.
70. Në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar vlerën e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit të përlllogaritura nga Komisioni, duke argumentuar se të gjitha udhëtimet e kryera nga ai apo familja e tij në vitin 2007, janë në drejtim të Malit të Zi dhe shpenzimet e kryera atje duhet t'u hiqen shpenzimeve të jetesës në Shqipëri, pasi nuk mund të përlllogariten dy herë shpenzime për jetesë brenda së njëjtës dite.
- Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, pasi konstatoi se gjatë vitit 2007 subjekti ka kryer 5 udhëtime njëditore në Malin e Zi, në tre prej të cilave ka udhëtuar me bashkëshorten dhe vajzën, trupi gjykues vlerëson se shpenzimet për konsum të njësisë ekonomike familjare, përfshijnë çdo lloj shpenzimi për blerje produktesh apo shërbimesh për të plotësuar nevojat individuale të anëtarëve të familjes. Struktura e tyre nuk përbëhet vetëm nga shpenzimet për ushqim, por përmbledh dymbëdhjetë grupe kryesore të shpenzimeve të konsumit, si: shpenzime për ujë, energji elektrike, veshje, mallra dhe shërbime, mirëmbajtje banese etj. Në këtë kuptim, shpenzimet ditore të jetesës, të përlllogaritura sipas standardit të INSTAT-it, nuk mund të kompensojnë apo zëvendësojnë shpenzimet ditore të një udhëtimi jashtë vendit. Bazuar në këtë argumentim, si dhe në faktin se shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit të përlllogaritura në analizën e kryer nga Komisioni, i përgjigjen përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve sipas standardit të vendosur në jurisprudencën e Kolegjit³⁵, trupi gjykues vlerëson se shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit janë përlllogaritur drejt nga Komisioni. Subjekti ka kundërshtuar gjithashtu shpenzimet e jetesës të përlllogaritura nga Komisioni, duke pretenduar se fëmija e tij ka qenë tepër i vogël për t'i përlllogaritur shpenzimet e jetesës së tij njëlloj me atë të një të rrituri. Në analizë të këtij pretendimi të subjektit, trupi gjykues

³⁵ Shih vendimin nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, të Kolegjit.

çmon të theksojë se treguesit statistikorë të konsumit vjetor janë përcaktuar si prodhim i shpenzimeve mesatare vjetore për frymë, në raport me numrin e anëtarëve të një familjeje, pavarësisht moshës së anëtarit përkatës. Subjekti, në vitin 2007 ka në pasur në përbërjen familjare tre persona, për këtë arsye shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur drejt nga Komisioni për tre familjarë, për atë kohë sa të dhënat statistikore nuk përfshijnë përjashtime mbi bazë grupmoshe. Në përmbledhje të analizës së bërë më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit në lidhje me zërat e analizës financiare të vitit 2007 të kryer nga Komisioni, nuk janë të bazuara dhe, për rrjedhojë, mbetet i drejtë vlerësimi i Komisionit se subjekti nuk ka pasur burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e kryera për vëllain e tij të {***}, Itali, në vlerën 101.284 lekë.

71. Analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2009 është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit në zërin e shpenzimeve të jetesës dhe në zërin e shpenzimeve të udhëtimit. Në lidhje me pretendimin e subjektit për përlllogaritjen e pasaktë nga Komisioni të shpenzimeve të jetesës për vitin 2009, trupi gjykues konstaton se ky është një pretendim i përsëritur i subjektit, i parashtruar në shkaqet e ankimit lidhur me kontrollin e kryer nga Komisioni për pasurinë automjet tip “Mercedes Benz”, blerë nga subjekti në vitin 2009. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson të mbajë të njëjtin qëndrim, si në paragrafin 37 të këtij vendimi, sipas të cilit shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit për vitin 2009, duhet të ishin përlllogaritur nga Komisioni në vlerën 430.427 lekë, vlerë e cila do të konsiderohet në analizën financiare në vijim.

Në lidhje me zërin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, trupi gjykues konstaton se subjekti ka parashtruar pretendimin se ato nuk janë përlllogaritur drejt nga Komisioni, duke përdorur të njëjtin argument si në analizën e vitit 2007, se shpenzimet e këtyre udhëtimeve duhen zbritur nga shpenzimet e jetesës, pasi edhe udhëtimet e kryera nga ai dhe familja e tij në vitin 2009 janë udhëtime njëditore me destinacion Malin e Zi, 14 gjithsej, në tetë prej të cilave ka udhëtuar me bashkëshorten dhe vajzën. Trupi gjykues vlerëson të mbajë të njëjtin qëndrim si në paragrafin 70 të këtij vendimi, duke e gjetur të drejtë vlerësimin e Komisionit, duke qenë se nga verifikimi i këtij zëri të analizës financiare, rezulton se përlllogaritjet janë kryer bazuar në standardin e përcaktuar tashmë në jurisprudencën e Kolegjit, në lidhje me metodologjinë e përlllogaritjes së shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit.

Pasi në analizën financiare për vitin 2009 u reflektua pretendimi i drejtë i subjektit të rivlerësimit në lidhje me shpenzimet e jetesës, si dhe të ardhurat e bashkëshortes së subjektit u përlllogaritën sipas arsyetimit të bërë në paragrafin 37 të këtij vendimi, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, pavarësisht korrektimit të rezultatit negativ të konkluduar prej Komisionit, mbetet me një balancë negative në përfundim të analizës financiare të kryer në Kolegj, në shumën 419.936 lekë.

Në përmbledhje të analizës së bërë më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se ka pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare për të përballuar shpenzimet e kryera në favor të vëllait të tij në {***}, Itali, në vite, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

72. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se bashkëshortja e tij nuk ka pasur pasuri të trashëguar për ta deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi në kundërshtim me sa ka konkluduar Komisioni, bashkëshortja nga pasuria e pretenduar, jo vetëm që nuk ka përfituar, por kjo pasuri nuk mund të jetë as objekt përfitimi duke qenë në proces legalizimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, në vendim³⁶, ka arritur në konkluzionin: *Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën e*

³⁶ Shih paragrafin “iv”, në faqen 34 të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit.

*pasurisë së rivlerësimit pjesën takuese të bashkëshortes së tij në një godinë 3-katëshe, ndodhur në {***}.*

73. Nga shqyrtimi i akteve të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, trupi gjykues vëren se Drejtoria e ALUIZNI-t për zonat turistike, me shkresën nr. {***} prot., datë 30.03.2018, i ka përcjellë Komisionit dokumentacionin që disponon në emër të z. Sh. S., babait të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, nga ku rezulton se z. Sh. S. ka paraqitur pranë këtij institucioni kërkesën nr. {***} prot., më datë 18.07.2013, për legalizimin e një ndërtese banimi 3-katëshe në {***} -Plazh, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi 525 m². Znj. Sh. S., nëna e bashkëshortes së subjektit, me kërkesën nr. {***} prot., datë 02.11.2015, ka depozituar pranë ALUIZNI-t dëshminë e trashëgimisë ligjore të të ndjerit z. Sh. S.. Nga verifikimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.09.2015, trupi gjykues konstaton se znj. I.S., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka trashëguar ¼ pjesë të barabartë të gjithë pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të babait të saj. Nga përmbajtja e dëshmisë së trashëgimisë nuk rezulton që ndonjë nga trashëgimtarët e z. Sh. S. të ketë hequr dorë nga trashëgimia, të jetë shpallur i padenjë për të trashëguar me vendim gjykate apo të jetë përjashtuar nga trashëgimia. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, bashkëshortja e subjektit, znj. I. S., ka plotësuar deklaratën e pasurisë së personit të lidhur, duke deklaruar në faqen 9 të formularit se nuk disponon pasuri veçmas të regjistruar në emër të saj, duke mosdeklaruar faktin e trashëgimit prej babait të saj në ¼ pjesë takuese. Në kushtet kur dëshmia e trashëgimisë ligjore është lëshuar më datë 16.09.2015, trupi gjykues verifikoi edhe deklaratimet periodike të interesave privatë të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, znj. I. S.³⁷, në vitet 2015 dhe 2016, dhe konstatoi se pjesa takuese në ¼ pjesë në pasurinë e paluajtshme ndërtesë 3-katëshe, ndodhur në zonën turistike {***}-Plazh, e përfituar nga trashëgimia ligjore, nuk është deklaruar asnjëherë prej saj.
74. Në analizë të kësaj situate faktike në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit në ankim, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit që ai dhe bashkëshortja nuk kanë përfituar asnjë pasuri nga çelja e trashëgimisë ligjore nuk qëndron, pasi sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.09.2015, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka trashëguar ¼ pjesë të barabartë të gjithë pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të babait të saj. Me depozitimin e kësaj dëshmie pranë ALUIZNI-t, kërkesa për legalizimin e banesës 3-katëshe në {***} ka kaluar në emër të trashëgimtarëve të z. Sh. S., një ndër të cilët është dhe znj. I. S., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit. Në referencë të nenit 331 të Kodit Civil, me çeljen e trashëgimit, trashëgimtarit i kalon edhe posedimi i trashëgimlënësit mbi pasurinë trashëgimore, pa qenë nevoja për të vënë dorë mbi atë, ndërsa në referencë të nenit 348, paragrafi i parë i po këtij kodi, cilësia si trashëgimtar dhe pjesët takuese në trashëgimi caktohen në dëshminë e trashëgimisë, të lëshuar nga noteri, pas paraqitjes së certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit, sipas rregullave të caktuara në këtë kod dhe në ligjin për noterinë. Në kuadër të këtyre parashikimeve ligjore, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka përfituar në cilësinë e trashëgimtares së babait të saj, ¼ pjesë takuese të të gjitha pasurive të tij të luajtshme dhe të paluajtshme, pavarësisht faktit nëse ka vënë dorë mbi to, duke përfshirë këtu edhe pjesën takuese në banesën 3-katëshe në {***}. Në përfundim të analizës si më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kishin detyrimin ligjor për të deklaruar pjesën takuese të saj, në banesën 3-katëshe në Velipojë, të fituar nëpërmjet trashëgimisë, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, detyrim që buron nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe parashikimet e neneve 30-32 dhe shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016. Edhe në kushtet e mospërdorimit të kësaj prone, apo mosnxjerrjes së të ardhurave prej saj, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, përsëri detyrimi

³⁷ *Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. I. S., ka qenë zyrtare deklaruese e interesave privatë pranë ILDKPKI-së, që nga viti 2003.*

për deklarim të pjesës takuese, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit. mbetet i njëjtë.

75. Trupi gjykues vlerëson se edhe pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit, se askush nuk ka të drejtën e disponimit të pasurisë në fjalë, pasi është në proces legalizimi, është i pabazuar. Sipas parashikimit të pikës 1 të nenit 2 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar³⁸, që individët të përfitojnë nga dispozitat e këtij ligji, ata duhet të disponojnë pasuritë e tyre. Ky fakt është pranuar nga vetë trashëgimtarët e z. Sh. S., ndër të cilët dhe znj. I. S., bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në momentin e depozitimit të dëshmisë së trashëgimisë pranë ALUIZNI-t.
- Në konkluzion, trupi gjykues e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit se mosdeklarimi i pjesës takuese të pasurisë së trashëguar të bashkëshortes, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pasaktë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.
- Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.***
76. Në lidhje me pretendimin e subjektit se mosdeklarimi në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit të automjetit tip “BMW”, me targë {***}, të blerë në vitin 2003, ka ardhur si pasojë e harresës dhe për asnjë qëllim tjetër, duke qenë se ky automjet është çregjistruar për shkak dëmtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni, në vendim³⁹, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit automjetin tip “BMW”, me targë {***}.
- Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar: *Veturë “BMW”, vit prodhimi 1996. Vlera 700.000 lekë. Pjesa që zotëron 100%. Targa {***}. Nuk është regjistruar akoma në emrin tim. Blerë nga shitja e një veture tjetër tip “BMW”, me targë {***}, në vlerë shitje.*
- Nga verifikimi i deklaratave periodike të mëvonshme të interesave, rezulton se subjekti nuk ka bërë deklarime për automjetin tip “BMW”, me targë {***}.
- Ky automjet nuk është deklaruar nga subjekti as në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.
- Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka deklaruar: *Makinën me targë {***} ia kam shitur shokut tim, nuk kujtoj sa lekë, por shumë pak [...]. Pastaj kam blerë “BMW” me targë {***}, me vlerë 200.000 lekë dhe jo 700.000 lekë [...]. Nëse në deklarimin tim figuron 700.000 lekë, ky është lapsus.*
- Subjekti ka paraqitur edhe “Akt shitblerjeje pasurie të luajtshme autoveturë”, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.09.2003, e lidhur mes tij, në cilësinë e blerësit, dhe z. A. K., në cilësinë e shitësit. Sipas përmbajtjes së aktit, shitësi i shet blerësit autoveturën tip “BMW”, me targë {***}, për çmimin 200.000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
77. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se mosdeklarimi i automjetit për efekt të procesit të rivlerësimit ka ardhur si pasojë e harresës dhe nuk ka qenë i qëllimshëm, pasi ky automjet është çregjistruar për shkak dëmtimi, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në zbatim të neneve 30 e 31 të ligjit nr. 84/2016 e të shtojcës 2 bashkëngjitur këtij ligji, kishte detyrimin të deklaronte marrëdhënien e tij me këtë pasuri, në kushtet kur subjekti nuk ka paraqitur asnjë akt provues se mjeti është çregjistruar për shkak dëmtimi dhe ky pretendim nuk është provuar as nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni.

³⁸ Sipas pikës 1 të nenit 2 ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i cili në pikën 1 të tij parashikon se: “1. Ky ligj zbatohet për ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më 27.6.2014, me funksione banimi, veprimtari ekonomike apo funksione të tjera social-kulturore, dhe që disponohen nga individë apo persona juridikë të regjistruar, përfshirë dhe ndërtimet pa leje, për të cilat subjektet nuk kanë kryer procedurën e vetëdeklarimit për legalizim, sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj”.

³⁹ Po aty, në faqen 34.

Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk ka deklaruar automjetin tip “BMW”, me targë {***}, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

78. Në lidhje me pretendimin e subjektit se përfundimi i arritur nga Komisioni në lidhje me automjetin tip “BMW”, me targë {***}, është i gabuar dhe jashtë objektivit të hetimit administrativ, pasi ai ka paraqitur prova gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, se ka pasur të drejtë ta shiste këtë automjet, trupi gjykues konstaton se në vendim⁴⁰, Komisioni, për pasurinë automjet tip “BMW”, me targë {***}, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk provoi se kishte tagrat e përfaqësimit për të shitur automjetin tip “BMW”, me targë {***}.
79. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton situatën faktike si vijon.
- DPSHTRr ka përcjellë në Komision⁴¹ dosjen e automjetit me targë {***}, në të cilën gjendet “Akt shitje pasurie të luajtshme autoveturë” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2012, e lidhur mes z. A. P., i përfaqësuar me prokurë të posaçme nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e shitësit dhe z. A. B., në cilësinë e blerësit. Sipas këtij akti shitjeje, z. A. P., nëpërmjet përfaqësuesit të tij, ka shitur automjetin tip “BMW”, me targë {***}, për shumën 130000 lekë.
- Në prokurën e posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.05.2009, e cila gjendet në dosjen e automjetit, z. A. P. i ka dhënë subjektit të rivlerësimit tagër dhe kompetencë të plotë që të drejtojë brenda territorit shqiptar automjetin tip “BMW”.
- Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, ka deklaruar se ai ka pasur tagrin për ta shitur këtë automjet. Për të mbështetur këtë pretendim, ai ka paraqitur një fotografim të prokurës së posaçme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.05.2009, në të cilën, në ndryshim nga prokura e posaçme, pjesë e dokumentacionit të dosjes së automjetit tip “BMW”, e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, gjendet fraza: *Njëherazi përfaqësuesi ka tagër dhe kompetencë që ta targojë e në vijim shesë tek çdo palë e tretë.*
- Subjekti i rivlerësimit, në këtë fazë të hetimit administrativ, ka paraqitur gjithashtu edhe “Vërtetim të fotokopjes me origjinalin” nr. {***} rep., datë 27.12.2018, të noteres O. K., e cila deklaron se “Prokura nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.05.2009, siç do të vëreni, është në dy kopje, meqenëse në momentin e parë nga ana ime, noteres, për gabim material, nuk është referuar e drejta e shitjes si tagër i deleguar, dhe në vijim në të njëjtën datë i njëjti përfaqësues më ka vënë në dukje saktësimin e vullnetit të tij, duke e plotësuar këtë akt”.
- Nga të dhënat e sistemit TIMS, rezulton se subjekti, megjithëse kishte tagrin për të drejtuar automjetin tip “BMW” vetëm brenda territorit shqiptar, ka udhëtuar me këtë mjet drejt Malit të Zi, duke kaluar kufirin rreth 35 herë gjatë periudhës 25.05.2009 - 16.12.2011.
 - Nga të dhënat e përcjella në Komision nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka prerë rregullisht polica sigurimi “TPL” për automjetin tip “BMW”, me targë {***}, për periudhën 19.05.2010 - 20.05.2012, pra edhe pas datës së shitjes së automjetit.
80. Në analizë të situatës faktike të përshkruar më lart, në raport me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson së pari se akti “Vërtetim i fotokopjes me origjinalin” nr. {***} rep., datë 27.12.2018, i noteres O. K., jo vetëm është në tejkallim të kompetencave të saj si notere publike, të përcaktuara në nenin 39⁴² të ligjit të kohës nr. 7829, datë 1.09.1994,

⁴⁰ Shih konkluzionin në faqen 34 të vendimit nr. 97, datë 10.01.2018, të Komisionit.

⁴¹ Informacioni është përcjellë në Komision nga DPSHTRr, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.10.2018.

⁴² Neni 39 i ligjit nr. 7829, datë 1.09.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar.

“Për noterinë”, i ndryshuar, por gjithashtu nuk përputhet me të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ, nga ku rezulton se në aktin e shitjes së kësaj makine, i cili është redaktuar nga po e njëjta notere, vetë subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e përfaqësuesit, nuk ka paraqitur prokurën e pretenduar si të korrigjuar, por prokurën në të cilën ai nuk e ka të shprehur tagrin për të shitur automjetin tip “BMW”. Për më tepër, në kundërshtim me sa pretendon noterja, nga aktet e paraqitura prej saj, rezulton se nuk ka korrigjim akti, por ajo ka vërtetuar si të njëjtë me origjinalin dy akte me të njëjtët numra regjistrimi, por me përmbajtje të ndryshme. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se akti “Vërtetim të fotokopjes me origjinalin” nr. {***} rep., datë 27.12.2018, i noteres O. K., i paraqitur nga subjekti, nuk arrin të provojë se ky i fundit kishte tagrin e përfaqësimit për të kryer shitjen e automjetit tip “BMW”, më datë 31.01.2012.

81. Trupi gjykues mori në analizë edhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.08.2018, nëpërmjet së cilës z. A. P. deklaroi se automjetin tip “BMW” e ka përdorur dhe z. Arben Zefi, të cilit i kishte lënë një prokurë për ta përdorur dhe për ta shitur, si dhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.12.2018, nëpërmjet së cilës z. A. B. deklaroi se në fund të vitit 2012 ka realizuar shitjen të noteri për automjetin tip “BMW”, por paratë ia ka dhënë z. A. P., kur ka ardhur në verë në Shqipëri. Këto akte janë paraqitur nga subjekti bashkëlidhur shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit dhe janë pretenduar prej tij edhe në ankim, si akte që vërtetojnë se ai ka pasur të drejtë të shiste automjetin tip “BMW”, në vitin 2012.

Trupi gjykues vlerëson se deklarata noteriale e z. A. P. nuk provon se subjekti i rivlerësimit kishte tagrin e shitjes së automjetit tip “BMW”, pasi pavarësisht perceptimit të mundshëm të tij se i ka dhënë përfaqësuesit të tij të drejtën për të shitur automjetin, prokura e paraqitur nga përfaqësuesi Arben Zefi përpara noterit, me qëllim lidhjen e kontratës së shitjes, nuk e ka pasur të shprehur këtë tagër, por vetëm atë të përdorimit të tij.

Ndërsa deklarata noteriale e z. A. B. nuk përmban të dhëna relevante për zgjidhjen e çështjes. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit në ankim, se ka pasur të drejtë ta shiste automjetin tip “BMW”, është i pabazuar.

82. Trupi gjykues, në vijim të analizimit të pretendimit të subjektit, konstaton se Komisioni, në vendim⁴³, ka arsyetuar se: *Duke marrë në konsideratë faktin që ky mjet nuk është përdorur asnjëherë nga blerësi i tij, i është lënë në përdorim subjektit të rivlerësimit që në momentin e zhdoganimit, si dhe ai e ka shitur këtë mjet pa pasur tagrat e përfaqësimit, ngrihen dyshime të arsyeshme se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi të fshehur automjetin, tip “BMW” [...]. Në përfundim, Komisioni, pasi analizoi deklaratimet e subjektit dhe provat e dorëzuara prej tij, konkludon se ai nuk arriti të provojë se kishte tagrat për të shitur automjetin, tip “BMW”.*

Më tej, në konkluzionet për pasuritë e padeklaruara dhe në konkluzionet përfundimtare për vlerësimin e kriterit të pasurisë, ka arritur në konkluzionin se: “Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk provoi se kishte tagrat e përfaqësimit për të shitur automjetin, tip “BMW”, me targë {***}”.

Trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka arritur në një konkluzion të gabuar. Deklarata e pasurisë së rivlerësimit [shtojca nr. 2 e ligjit nr. 84/2016], në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, kërkon nga subjekti i rivlerësimit që të deklarojë të gjitha pasuritë e akumuluar ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, sipas nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016,

“Noteri ka këto kompetenca: a) redakton aktet noteriale; b) bën njoftimin e kujtesje noteriale ose të akteve të tjera jashtëgjyqësore; c) legalizon nënshkrimet e shtetasve të vëna në akte të ndryshme; ç) harton kundërshtimet e kambialeve dhe vërtetimin e mospagimit të çekut; d) vërteton datën e paraqitjes së dokumenteve në zyrën e noterisë; dh) vërteton qenien e një personi dhe qëndrimin e tij në një vend të caktuar; e) pranon për ruajtje dokumente të personave fizikë e juridikë në zyrën noteriale; ë) lëshon kopje, shkurtime e pjesë të akteve të depozituara në zyrën noteriale; f) vërteton se kopjet ose shkurtimet e dokumenteve janë të njëjta me origjinalin e paraqitur nga të interesuarit; g) bën ose vërteton përkthime nga një gjuhë në një tjetër; gj) redakton procesverbale e bën inventare, duke përshkruar gjendjen e sendeve, sipas kërkesës së shtetasve dhe kur ngarkohen nga gjykata; h) redakton deklaratat e dokumente të kërkuara nga persona të interesuar, si dhe akte e veprime të tjera, që sipas ligjit duhet të bëhen nga noteri.

⁴³ Shih faqen 32 të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit.

burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur. Neni 3 i ligjit nr. 84/2016 përkufizon si “pasuri” të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore në rastin konkret, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk kishte detyrimin për të deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, përdorimin e automjetit tip “BMW”, me targë {***}, pasi kjo pasuri nuk ishte në përdorim prej tij në momentin e dorëzimit të kësaj deklarate. Për pasojë, konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, pasi nuk provoi se kishte tagrat e përfaqësimit për të shitur automjetin tip “BMW”, me targë {***}, është i gabuar.

Por, pavarësisht se e gjen të drejtë pretendimin e subjektit se ai nuk ka bërë deklarim të pasaktë për pasurinë automjet tip “BMW”, me targë {***}, në funksion të faktit të provuar gjatë hetimit administrativ në Komision, se subjekti ka shitur automjetin tip “BMW” pa pasur tagrin për ta kryer këtë veprim juridik, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime kontradiktore dhe në kundërshtim me situatën faktike të provuar gjatë hetimit administrativ, rrethanë e cila do të mund t’i nënshtrohej vlerësimit të trupit gjykues të Kolegjit, nëse do të ishin vlerësuar të tria kriteret e rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i bazuar.

C. *Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës*

83. Trupi gjykues, në lidhje me vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës për subjektin e rivlerësimit, konstaton se Komisioni, në vendim, ka arritur në përfundimin:

Komisioni bazuar në provat e dokumentet që disponon dhe vlerësimin e çështjes në tërësi në lidhje me kriterin e figurës, arrin në përfundimin se konstatimet në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, por këto konstatime mund të konsiderohen në vlerësimin tërësor të procedurave të kontrollit të figurës, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar përfundimin e mësipërm, duke pretenduar edhe kuptimin dhe zbatimin e gabuar të ligjit material nga ana e Komisionit, që sipas tij ka ndikuar në një vendimmarrje të padrejtë për të.

84. *Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni dhe DSIK-ja, kanë shkelur nenin Ç, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, pasi Komisioni është njohur me të dhëna që janë klasifikuar “sekret shtetëror”, duke ia lejuar DSIK-ja aksesin në këto të dhëna dhe se dispozitat e ligjit nr. 84/2016 nuk parashikojnë, kurrsesi, që njohja me përmbajtjen e dokumentit të klasifikuar t’i refuzohet subjektit të rivlerësimit që i nënshtrohet kontrollit, trupi gjykues, në analizë të këtij shkak ankimi, në referencë të parashikimeve ligjore në lidhje me kompetencat e organeve të rivlerësimit dhe DSIK-së në raport me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, vlerëson se ky pretendim është i pabazuar, pasi nga një lexim i kujdesshëm i pikës 4 të nenit*

Ç të Aneksit të Kushtetutës⁴⁴, evidentohet se aksesit në bazat e të dhënave shtetërore, si një mjet i rëndësishëm për kërkimin e provës gjatë hetimit të çështjes, ndahet në dy drejtime: (i) akses i drejtpërdrejtë, i cili është detajuar në nenin 50 të ligjit nr. 84/2016 në drejtim të të dhënave të aksesueshme dhe faciliteteve të aksesimit të tyre; (ii) akses jo i drejtpërdrejtë, që lidhet me të dhënat “sekret shtetëror”.

Parashikimi kushtetues në asnjë moment nuk ka ndaluar organet e rivlerësimit të kenë akses në të dhënat “sekret shtetëror”, por këtë akses e ka kanalizuar nëpërmjet përcjelljes së informacionit nga DSIK-ja, i cili është organi ndihmës i specializuar. Raporti që DSIK-ja u përcjell organeve të rivlerësimit është një dokument i klasifikuar “sekret shtetëror”, në mbështetje të përcaktimeve të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, *Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”*, i ndryshuar. Ky raport, në bazë të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, i dërgohet Komisionit, i cili më pas i kërkon DSIK-së deklasifikimin e tij, për t’ia vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit, si dhe me qëllim të përdorimit të tij si provë në procesin e rivlerësimit.

Ky qëndrim i trupit gjykues gjen mbështetje edhe në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit dispozitat e ligjit nr. 84/2016 garantojnë aksesin në të gjithë informacionin dhe dokumentet e disponuara nga grupi i punës së DSIK-së dhe garantojnë kontrollin efektiv nga Komisioni mbi veprimtarinë e grupit të punës, por në të gjitha rastet, autoriteti vendimmarrës mbetet tek organet e rivlerësimit (Komisioni dhe Kolegji) të krijuara për këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme.

85. Trupi gjykues e gjen të pabazuar edhe pretendimin tjetër të subjektit të rivlerësimit se përcaktimi i nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 nuk ka të bëjë me përcaktimin e “sekretit shtetëror”, por me përdorimin e kufizuar të këtij dokumenti për të mos u bërë publik për një interes të ligjshëm, por jo t’i refuzohet subjektit të rivlerësimit njohja me të. Trupi gjykues vlerëson se parashikimi i nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “Informacioni nuk bëhet publik nëse ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër”, përcakton rastet kur nuk mund të deklasifikohet informacioni që përmban raportin e DSIK-së. Duke qenë se raporti i DSIK-së është një dokument i klasifikuar, parashikimi i nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 duhet interpretuar e lidhur me përcaktimet e nenit 16 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, *Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”*, i ndryshuar, i cili parashikon: “Një informacion mund të përjashtohet nga deklasifikimi, kur ekspozimi i tij: a) zbulon identitetin e burimit konfidencial, zbatimin e një metode apo të një burimi informativ; b) nxjerr informacion që dobëson veprimtarinë e kriptologjisë; c) nxjerr informacion që mund të dobësojë planet e ngutshme të sigurimit kombëtar; ç) dëmton një traktat apo marrëveshje ndërkombëtare, marrëdhëniet midis Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të huaja apo veprimtarinë e mëtejshme diplomatike”. Duke u kthyer në rastin konkret, DSIK-ja, nëpërmjet Komisionit të Deklasifikimit, Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në përputhje me përcaktimet ligjore të sipërcituara, ka deklasifikuar atë pjesë të raportit mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, që është çmuar e nevojshme për procesin e rivlerësimit. Informacioni

⁴⁴ Pika 4 e nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës parashikon se: “4. Komisioni ose Kolegji i Apelit, sipas rastit, përmes personelit të tyre, Komisionerit Publik ose vëzhguesit ndërkombëtar, shqyrton deklaratat e subjektit të rivlerësimit për të shkuarën e tij, interviston personat e përmendur në deklaratë ose persona të tjerë, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore ose të huaja për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve. Komisioni, Kolegji dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë akses të drejtpërdrejtë në të gjitha bazat e të dhënave qeveritare, përveç atyre që janë klasifikuar “sekret shtetëror”, duke përfshirë edhe dosjet personale të të rivlerësuarit, të dhënat statistikore, dosje të përzgjedhura për rivlerësim, vëtvlerësimet, mendimet e eprorëve, të dhënat për trajnimet dhe ankimet ndaj të rivlerësuarve, rezultatet e verifikimit të ankesave, vendimet për marrjen e masave disiplinore ndaj të rivlerësuarve, të dhënat për pronat e të rivlerësuarit, llogaritë bankare, të dhënat tatimore, të dhënat për automjetet, të dhënat për hyrje-daljet në kufi, si dhe çdo dokument tjetër të dobishëm. Komisioni ose Kolegji mund të urdhërojë individë dhe shoqëri tregtare të dëshmojnë ose të japin prova në përputhje me ligjin.”

i deklasifikuar i është vënë në dispozicion subjektit dhe ai ka pranuar njohjen me të⁴⁵. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se mosbërja e njohur e pjesës së informacionit të klasifikuar, nuk përbën në vetvete një shkelje të dispozitave kushtetuese e ligjore e, për rrjedhojë, edhe e të drejtave themelore të subjektit të rivlerësimit.

86. Këtë qëndrim, trupi gjykues e mbështet edhe në jurisprudencën e GjEDNj-së, sipas së cilës zbulimi i të gjitha provave relevante për çështjen nuk është një e drejtë absolute. Në disa raste, mund të jetë e nevojshme mosdhënia e disa provave të akuzuarit, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individëve të tjerë ose ruajtjen e interesit publik. Sipas kësaj jurisprudence, të tilla masa, të cilat janë të domosdoshme, janë të lejueshme sipas nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së⁴⁶.

Në dritën e kësaj jurisprudence, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur informacion të mjaftueshëm të përcjellë me rezultatet e hetimit administrativ, mbi faktet dhe burimet në të cilat DSIK-ja ka mbështetur konstatimin e saj në funksion të hetimit administrativ. Këtë përfundim, trupi gjykues e arrin mbështetur në situatën faktike të rezultuar nga aktet e hetimit administrativ dhe të pasqyruar edhe nga Komisioni, në vendim⁴⁷, sipas së cilës DSIK-ja ka dërguar në Komision një raport me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017 për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin është konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës. Në raportin e përditësuar me informacione të organeve ligjzbatuese për subjektin e rivlerësimit Arben Zefi, të depozituar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 25.04.2018, DSIK-ja, përfundimisht, ka konstatuar papërshtatshmërinë e tij për ushtrimin e detyrës. Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 03.05.2018, i ka kërkuar DSIK-së deklasifikimin e raportit për subjektin e rivlerësimit. Duke qenë se raporti i parë i hartuar nga DSIK-ja ka qenë pozitiv, por më pas është rishikuar duke arritur në një konkluzion të ndryshëm, bazuar në informacionet e ardhura nga organet ligjzbatuese, të cilat mungonin në raportin e parë, me të drejtë Komisioni nuk e ka vlerësuar këtë raport si relevant për procesin e rivlerësimit, pasi u ka dhënë vlerë provuese të dhënave të raportit të fundit të deklasifikuar pjesërisht nga DSIK-ja, në të cilin subjekti është konstatuar si i papërshtatshëm për ushtrimin e detyrës, mbështetur në rrethanat e konstatuara nga grupi i punës pranë këtij organi. Deklasifikimi i dokumentacionit “sekret shtetëror” për t’ia bërë më pas të njohur këtë dokumentacion subjektit të rivlerësimit, është bërë nga DSIK-ja në mënyrë proporcionale, aq sa e ka konsideruar të arsyeshme dhe të nevojshme, në funksion të garantimit të të drejtave të subjektit për t’u njohur me dokumentacionin e hetimit, me qëllim realizimin e së drejtës së tij për t’u mbrojtur dhe garantimit të mbrojtjes së sekretit shtetëror, në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, *Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”*, të ndryshuar.

Në përfundim të këtij arsyetimi, trupi gjykues çmon se edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit se i është refuzuar njohja me dokumentacionin e klasifikuar në kundërshtim me ligjin, është i pabazuar.

87. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjithashtu, në ankim, se Komisioni ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi ka ushqyer mediat me mllef e përfundime të pasakta e të padrejta ndaj tij. Subjekti ka cituar në ankim disa tituj lajmesh nga shtypi i ditës, të cilat konstatohet se lidhen me komente të shtypit, pas shpalljes së vendimit nga Komisioni. Trupi gjykues, në analizë të këtij pretendimi të subjektit, vlerëson se interesi i medias për procesin e rivlerësimit ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve është më se i kuptueshëm, në funksion edhe të qëllimit të parashikimeve kushtetuese dhe atyre të ligjit nr. 84/2016 për rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sidomos në kushtet kur mediat janë të pranishme në seancat

⁴⁵ Subjekti ka nënshkruar aktet “Deklaratë”, në datat 12 dhe 13 dhjetor 2018, në të cilat ka pranuar marrjen e të gjithë dokumentacionit të dosjes së hetimit administrativ në Komision.

⁴⁶ Shih vendimet e GjEDNj-së në çështjet Regner kundër Çekisë, 2017 (Dhoma e Madhe) dhe Leas kundër Estonisë, 2012 (Final, Seksioni i Parë).

⁴⁷ Shih faqen 35 të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit.

dëgjimore publike të zhvilluara nga Komisioni. Subjekti nuk ka paraqitur asnjë provë, që në mënyrë objektive të vërtetojë se Komisioni ka ushqyer mediat në fjalë me mllef ndaj tij. Interpretimi nga mediat i fakteve të parashtruara nga relatori i çështjes së trupit gjykues të Komisionit gjatë seancës dëgjimore publike, nuk është në përgjegjësinë e autoriteteve shtetërore, aq më tepër të Komisionit, ndërsa pretendimi i subjektit për cenim të figurës së tij për shkak të lajmeve të publikuara në media për të, është një çështje që nuk lidhet me procesin e rivlerësimit, për pasojë nuk është objekt shqyrtimi i trupit gjykues të Kolegjit.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

88. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni dhe DSIK-ja kanë shkelur nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, duke shtrirë objektin e hetimit dhe nxjerrë përfundime jashtë objektit kushtetues të kriterit të kontrollit të figurës. Komisioni, duke mos bërë asnjë arsyetim në lidhje me veprimin ose mosveprimin e subjektit të rivlerësimit, si dhe me faktet apo rrethanat që do të provonin se ai kishte cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, ka shkelur detyrimin ligjor të arsyesimit të vendimit.*

Në analizë të këtij shkak ankimi, trupi gjykues konstaton se me shkresën nr. {***} prot., datë 09.05.2018, DSIK-ja ka përcjellë raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, i deklasifikuar pjesërisht me vendim të Komisionit të Deklasifikimit, Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” nr. {***}, datë 19.05.2018.

Në këtë raport, grupi i punës së DSIK-së konstaton se në vlerësim të informacioneve të siguruar nga autoritetet verifikuese, për subjektin e rivlerësimit, evidentohet fakti i mosdeklarimit nga ana e tij të kontakteve të papërshtatshme që ka pasur me persona të përfshirë në krimin e organizuar, parashikuar në pikën 4, shkronjat “b” dhe “c” dhe në pikën 6, shkronja “c” e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit apo pastërtisë së figurës së subjektit të rivlerësimit, grupi i punës së DSIK-së konstaton se të dhënat që disponohen dhe çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje apo moskryerje të veprimeve në kundërshtim me ligjin, në mospërmbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale të padrejta për vete si funksionar publik apo persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesin e ligjshëm të shtetit, apo personave të tjerë, cenon figurën e tij, integritetin, shkallën e besueshmërisë dhe e bën subjektin e rivlerësimit të mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale, vlerësim i mbështetur në shkronjat “b” dhe “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, grupi i punës ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit.

Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni, në lidhje me konstatimin e raportit të DSIK-së, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë asnjë shpjegim, me argumentin se nuk është njohur me asnjë akt apo provë.

Në vendim, Komisioni ka arritur në përfundimin se *bazuar në provat e dokumentet që disponon dhe vlerësimin e çështjes në tërësi në lidhje me kriterin e figurës, konstatimet në lidhje me këtë kriter nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas nenit 61, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, por këto konstatime mund të konsiderohen në vlerësimin tërësor të procedurave të kontrollit të figurës, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

89. *Trupi gjykues vlerëson se mënyra e kontrollit të figurës detajohet brenda parimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016 që, në nenin 34 të tij, përcakton qartë objektin e kontrollit të figurës: “Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës”. Standardet e kontrollit të figurës përcaktohen nga neni 38, pika 3, sipas së cilës: *Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në**

konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6, të këtij neni, dhe rrethanat lehtësuese, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni. Vlerësimi duhet të përmbajë rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese të këtij konstatimi. Nëse vlerësimi nuk përmban elementet e parashikuara në këtë paragraf, konsiderohet i paplotë”.

Rrethanat ku duhet të bazohet vlerësimi sa i përket kontrollit të figurës, përcaktohen në paragrafin 4 të po këtij neni, sipas të cilit konstatohet se ekziston një kontakt i papërshtatshëm i subjektit me një person të përfshirë në krimin e organizuar, kur: a) *subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar; b) subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar; c) subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar; ç) subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar; d) subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar, ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës”.*

90. Duke u kthyer në zbatimin e këtyre dispozitave në rastin konkret, trupi gjykues vlerëson se informacioni i përcjellë nga DSIK-ja nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016. Raporti i DSIK-së nuk referon në asnjë moment se cilët janë personat e përfshirë në krimin e organizuar, me të cilët subjekti ka pasur kontakte të tilla që të ketë shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri.

Në përputhje me parimin e objektivitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij, ndërsa në raportin e DSIK-së nuk ka asnjë shpjegim se cila është prova/ngjarja që provon se subjekti i rivlerësimit i kishte kryer veprimet korruptive, por grupi i punës ka mbetur vetëm në nivelin e dyshimeve, në kundërshtim me detyrën që i ka ngarkuar neni 39 i ligjit nr. 84/2016.

91. Komisioni, në vendim, ka arritur në përfundimin se *konstatimet në lidhje me këtë kriter nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas nenit 61 pika 2 e ligjit nr. 84/2016*, por i ka konsideruar ato si shkak shkarkimi sipas nenit 61, pika 5, pasi subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Trupi gjykues, në këtë vlerësim të Komisionit, nuk identifikon se cili është arsyeimi që ka drejtuar këtë konkluzion, por në leximin e tij në harmoni me konstatimet e DSIK-së, arrin të deduktojë se cenimin e besimit të publikut, Komisioni e ka lidhur me veprimtarinë e kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit në disa procese gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e konstatuar kjo nga DSIK-ja në raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, i deklasifikuar pjesërisht. Trupi gjykues vlerëson se Komisioni nuk ka arsyetuar se cilat kanë qenë veprimet ose mosveprimet e subjektit të rivlerësimit apo rrethanat konkrete, të cilat janë provuar gjatë hetimit administrativ dhe cilat kanë qenë pasojat që ato kanë prodhuar, të tilla që i kanë krijuar bindjen se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Edhe nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ, trupi gjykues nuk konstaton ekzistencën e akteve që dëshmojnë për një hetim të mundshëm të Komisionit, në këtë drejtim. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni nuk ka arritur të arsyetojë se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në atë nivel, saqë e bën të pamundur vazhdimin e ushtrimit të detyrës prej tij, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues i Kolegjit, në ndryshim nga Komisioni, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i bazuar.

92. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara në shkaqet e ankimit, parashtrimet e paraqitura prej tij me shkrim, 5 ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, si dhe të gjitha provat e aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ për këtë çështje, arriti në përfundimin se vendimi nr. 97, datë 10.01.2019, i Komisionit është i drejtë, bazuar në konkluzionet si vijojnë.

92.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

1. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 132,8 m², subjekti i rivlerësimit:

a) ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;

b) ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për blerjen e këtij apartamenti, siç parashikohet në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

2. Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 56,1 m², subjekti i rivlerësimit, për shkak të mosdeklarimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, të shumës prej 1.900.000 lekësh të përfituar nga shitja e këtij apartamenti, ndodhet në kushtet e deklaramit të pasaktë, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

3. Për pasurinë automjet tip “BMW”, me targë {***}, blerë në vitin 2007, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit, si dhe vlerën e paguar për këtë pasuri, në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

4. Për pasuritë automjet tip “Mercedes Benz {***}” me targë {***} dhe automjet tip “Volkswagen Passat” me targë {***}:

a) subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk ka deklaruar vlerën e kontratës së shitblerjes së automjetit tip “Mercedes Benz” dhe burimin e krijimit të kësaj pasurie, në kundërshtim me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;

b) subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e pasurisë automjet tip “Mercedes Benz {***}”, me targë {***}, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

5. Për pagesën e shumës 50000 euro kundrejt shoqërisë “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit:

a) ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk ka deklaruar pagimin e shumës 50000 euro si paradhënie për përfitimin e një sipërfaqeje ndërtimi (banimi dhe shërbimi) te shoqëria “{***}” ShPK në vitin 2007, në kundërshtim me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;

b) ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për dhënien e shumës 50000 euro shoqërisë “{***}” ShPK, në përputhje me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016;

c) gjendej në situatën e konfliktit të interesit, pasi ka shqyrtuar një padi të shoqërisë “{***}” ShPK, duke qenë ende në marrëdhënie interesi me të.

6. Për likuiditetet, subjekti i rivlerësimit:

a) ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, për shkak të mosdeklarimit të depozitës bankare dhe gjendjes së llogarisë bankare të pagës, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016;

b) ka pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare për të përballuar shpenzimet e kryera në favor të vëllait të tij në {***}, Itali, në vite, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016;

c) ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk ka deklaruar marrëdhënien e tij me shumën prej 100.000 USD, e kaluar në llogarinë e tij bankare

në datën 13.08.2007 nga një person i tretë dhe e tërhequr në datat 13.08.2007 dhe 15.08.2007, në kundërshtim me parashikimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

7. Për pasurinë godinë 3-katëshe e ndodhur në {***}, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit për shkak të mosdeklarimit të pjesës takuese, të trashëguar, të bashkëshortes në këtë pasuri, në kundërshtim me parashikimet të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

8. Për pasurinë automjet tip “BMW”, me targë {***}, të blerë në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pasi nuk e ka deklaruar këtë pasuri në kundërshtim me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

9. Për pasurinë automjet tip “BMW”, me targë {***}, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime kontradiktore dhe në kundërshtim me situatën faktike të provuar gjatë hetimit administrativ, rrethanë e cila do të mund t’i nënshtrohej vlerësimit të trupit gjykues të Kolegjit, nëse do të ishin vlerësuar të tria kriteret e rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

92.2 Për kriterin e kontrollit të figurës

Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara në ankim dhe arsyetimin e Komisionit në lidhje me këtë kriter vlerësimi, arrin në përfundimin se cenimin e besimit të publikut, Komisioni e lidh me *veprimtarinë e kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit në disa procese gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër*, e konstatuar kjo nga DSIK-ja në raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit.

Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se Komisioni nuk ka identifikuar se cilat janë veprimet hetimore të kryera prej tij për të vërtetuar nëse qëndrojnë apo jo konstatimet e raportit të DSIK-së, në lidhje me korrupsionin pasiv të subjektit të rivlerësimit. Në vendim nuk janë arsyetuar se cilat kanë qenë veprimet ose mosveprimet e subjektit të rivlerësimit apo rrethanat konkrete, të cilat janë provuar gjatë hetimit administrativ dhe cilat kanë qenë pasojat që ato kanë prodhuar, të tilla që i kanë krijuar Komisionit bindjen se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Edhe në aktet e dosjes së hetimit administrativ të përcjellë në Kolegji, nuk gjenden akte në lidhje me një hetim të mundshëm të Komisionit në këtë drejtim. Në këto kushte, rezulton se Komisioni nuk ka arritur të arsyetojë se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut, për të bërë të pamundur vazhdimin e ushtrimit të detyrës prej tij. Trupi gjykues i Kolegjit, në ndryshim nga Komisioni, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

93. Megjithëse disa prej shkaqeve të ankimit, të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit e të analizuara nga trupi gjykues i Kolegjit, rezultuan të bazuara, ato u vlerësuan prej tij si të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.
94. Në përfundim të shqyrtimit të të gjitha akteve e provave të administruara gjatë hetimit administrativ, shkaqeve të ankimit të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit, bazuar në konkluzionet si më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit Arben Zefi ka kryer deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në përputhje me nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
95. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi e gjykoi çështjen në dhomë këshillimi, në mbështetje të konkluzioneve të mësipërme, vlerëson se vendimi nr. 97, datë 10.01.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 97, datë 10.01.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Arben Zefi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 01.07.2020.

ANËTAR

Ardian Hajdari

nënshkrimi

ANËTARE

Ina Rama

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha Mulaj

nënshkrimi

RELATORE

Albana Shtylla

nënshkrimi

KRYESUES

Luan Daci

nënshkrimi

Vendimi nr. 16/4, datë 28.12.2020 me objekt: “Për interpretimin e vendimit nr. 10 (JR), datë 01.7.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese”.